



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

## STUDIME PASDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË

### TEZA

**“KUJDESTARIA E FËMIJËVE TË MITUR NË LEGJISLACIONIN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË  
VERIUT DHE NË TË DREJTËN KOMPARATIVE”**

Kandidati:

Doruntina Kreka

Mentori:

Doc. dr.Arta Selmani Bakiu

Tetovë, 2020

## DEKLARATA E AUTORËSISË

Unë Doruntina Kreka deklaroj me përgjegjësi të plotë se unë jam autore e këtij punimi dhe se ky punim nuk përmban pjesë të marra prej diku tjetër pa u cituar në formën e posaçme. Të gjitha referencat dhe citimet në punim janë bërë në formë të fusnotave.

Tetovë,

Doruntina Kreka

2020

## MIRËNJOHJE

Shpreh mirënjohje dhe falenderim për të gjithë personat që më kanë ndihmuar dhe më kanë përkrahur gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve, sidomos gjatë fazës së përgatitjes të këtij punimi. Falenderoj të gjithë profesorët e Fakultetit të Drejtësisë në UEJL për përkrahjen dhe motivimin gjatë studimeve të ciklit të parë dhe ciklit të dytë , ndërsa një falenderim dhe mirënjohje e veçantë i dedikohet mentores sime Doc.dr.Arta Selmani Bakiu dhe profesoreshës sime të dashur Prof.dr.Emine Zendeli të cilat më kanë përkrahur , ndihmuar dhe këshilluar deri në përfundimin dhe realizimin e këtij punimi.

Veçanërisht falenderoj familjen time e cila nuk është kursyer aspak që unë të arrij sot këtu ku jam ,më kanë përkrahur,këshilluar dhe motivuar në secilën fazë të jetës time ,u jam mirënjohëse pa fund për të gjithë mundesinë që ma dhanë dhe besimin e plotë që patën tek unë.

Gjithashtu falenderoj shokun tim të jetës i cili më ka motivuar dhe përkrahur gjatë gjithë kohës që unë të arrij sa më shumë.

Falenderoj shumë edhe Avokatin Ardian Demiri për ndihmën dhe bashkëpunimin për rastet nga praktika.

Një falenderim i veçantë i dedikohet mikes sime Donika Bakiut e cila e lekturoi këtë punim.

Ju jam mirënjohëse pafund të gjithëve!

## **Përmbajtja**

### **Përmbledhje**

|                                   |    |
|-----------------------------------|----|
| 1. Hyrje.....                     | 7  |
| 2. Qëllimet e hulumtimit.....     | 8  |
| 3. Hipotezat.....                 | 10 |
| 4. Metodologjia e hulumtimit..... | 11 |
| 5. Rëndësia e punimit.....        | 12 |

## ***KAPITULLI I PARË: SHKURORËZIMI I MARTESËS DHE KUJDESTARIA E FËMIJËVE***

|                                                                                                                          |    |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 1.Shkurorëzimi i martesës .....                                                                                          | 13 |
| 1.1Shkurorëzimi i martesës me marrëveshje .....                                                                          | 15 |
| 1.2.Shkurorëzimi i martesës për shkak të marrëdhënieve të prishura dhe jetës së padurueshme ndërmjet bashkëshortëve..... | 17 |
| 1.3 Shkurorëzimi i martesës për shkak të pushimit faktik të jetesës bashkëshortore më gjatë se një vit.....              | 19 |
| 1.4.Kujdestaria e fëmijëve.....                                                                                          | 21 |
| 1.5.E drejta prindërore.....                                                                                             | 24 |
| 1.6 Të drejtat dhe detyrat e prindërve dhe fëmijëve.....                                                                 | 26 |
| 1.7 Marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve.....                                                                       | 28 |

## ***KAPITULLI I DYTË: PROCEDURA GJYQËSORE***

|                                         |    |
|-----------------------------------------|----|
| 2.Procedura në kontestet martesore..... | 30 |
| 2.1Roli i Qendrës për Punë Sociale..... | 33 |

|                                                                                                                                          |    |
|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 2.1.2 .Mendimi i Qendrës për Punë Sociale.....                                                                                           | 36 |
| 2.1.3 Vendosja e kontakteve personale midis fëmijës dhe prindit të cilit nuk i takon kujdestaria.....                                    | 38 |
| 2.2. Analizë e rastit konkret për shkurorëzimin e martesës dhe kujdestarinë e fëmijës së mitur në Republikën e Maqedonisë së Veriut..... | 41 |
| 2.3 Rasti Mitovi kundër RM-së.....                                                                                                       | 49 |

### ***KAPITULLI I TRETË: PËRGJEGJËSIA PRINDËRORE***

|                                                                                         |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|----|
| 3.Ushtrimi i të drejtës prindërore.....                                                 | 53 |
| 3.1. Mbikëqyrje gjatë ushtrimit të të drejtës prindërore.....                           | 54 |
| 3.2 Pasojat që shkakton shkurorëzimi i prindërve tek fëmijët në aspekt psikologjik..... | 56 |
| 3.3.Interesi më i lartë i fëmijës.....                                                  | 59 |
| 3.4 Kujdestaria e fëmijëve të mitur në të drejtën komparative.....                      | 61 |
| 3.5.Joint Custody-Prindëria e përbashkët.....                                           | 68 |
| 3.6.Ushtrimi i të drejtës prindërore në të drejtën komparative.....                     | 72 |

### ***KAPITULLI I KATËRT:***

|                        |    |
|------------------------|----|
| 4.DE LEGE FERENDA..... | 73 |
| 5.Konkluzione.....     | 77 |
| 6..Rekomandime.....    | 79 |
| 7.Bibliografia.....    | 81 |

## Përmbledhje

Shkurorëzimi mbetet një ndër faktorët që ndikon më së shumti në zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë. Pasojat më të rënda të shkurorëzimit i përjetojnë fëmijët.

Ndikimi i shkurorëzimit vërehet dukshëm edhe në sjelljen e prindërve dhe manifestohet edhe tek fëmijët, fati i të cilëve nuk dihet derisa të vendoset nga QPS. Ushtrimi i përgjegjësisë prindërore pas shkurorëzimit të martesës është një ndër temat më delikate .

Në këtë punim do të analizoj kujdestarinë ndaj fëmijëve pas shkurorëzimit të martesës –sipas Legjislacionit Familjar të RMV-së de lege lata dhe de lege ferenda. Do të përshkruaj se në RMV , ndarja e kujdestarisë i bëhet vetëm njërit prind sipas legjislacionit tonë familjarë i cili është ndër legjislacionet e pakta, që ende mban konceptin tradicional të ndarjes së kujdestarisë vetëm njërit prind , dhe de lege ferenda ku do të jap propozimet për prindëri të përbashkët bazuar në legjislacionet bashkëkohore të cilët promovojnë ushtrimin e përbashkët të prindërisë pas shkurorëzimit. Gjithashtu do të analizoj se si zbatohet në praktikë kujdestaria ndaj fëmijëve pas shkurorëzimit të martesës ,raste nga praktika se cilit prind i është dhënë kujdestaria , do të analizoj punën e qendrës për punë sociale ,vendimin që e japin ato për kujdestarinë e fëmijëve , efektin ,gjithashtu do të analizoj se si vendos gjykata duke u bazuar në vendimin e Qendrës për Punë Sociale dhe së fundmi efektin e këtij vendimi dhe realizimi i saj në praktikë.

**Fjalët kyçe:**Kujdestaria ndaj fëmijëve pas shkurorëzimit të martesës, vendimi i QPS ,vendimi i gjykatës,ushtrimi i përgjegjësisë prindërore,Interesi më i lartë i fëmijës

## Abstract

### **THE CUSTODY OF THE CHILDREN AFTER THE MARRIAGE DIVORCE ACCORDING TO THE REPUBLIC OF NORTH MACEDONIA LAW**

#### Abstract

Divorce remains one of the main factors which affects the development of the family and society. The children are the ones who deal with the worst consequences.

Divorce changes the behavior between both parents and it affects their children, whose destiny is unknown until it is decided by the Center of Social Work (CSW). One of the main subjects is the parent's responsibility after the divorce.

In this paper, the author talks about the custody of the children after the marriage divorce according to the Republic of North Macedonia law. The author also mentions the fact that the marriage divorce law of Republic of North Macedonia still maintains the same traditional concept, which means only one of the parents has the right to share child custody. This paper promotes some of the exercises parents should practice after their marriage divorce. It is mentioned how they should practice child custody, the role of the Center of Social Work (CSW), court's final decision of which parent will share child custody based on CSW's suggestion.

Key Words: Child custody after divorce, Center of Social Work's decision, Court's decision, Parental responsibility after marriage divorce.

## 1. Lënda e hulumtimit

Shkurorëzimi mbetet një ndër faktorët që ndikon më së shumti në harmoninë familjare. Pasojat e shkurorëzimit të martesës i vuajnë më së shumti fëmijët, ata janë viktimë të marrëdhënieve jo të mira të prindërve të tyre për arsye se e gjithë energjia negative që kanë partnerët gjatë shkurorëzimit manifestohet edhe tek fëmijët dhe se e gjithë sjellja e tyre ndikon gjatë zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe gjendjes psikike.

Lëndë e këtij hulumtimi do të jetë kujdestaria e fëmijëve të mitur, ku do të analizohen dispozitat e legjislacionit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me theks të veçantë dispozitat e ligjit për familje të R.M.V që e rregullon këtë institut, si dhe ligjet tjera që i vihen në ndihmë këtij ligji për të rregulluar procedurën e kujdestarisë së fëmijëve. Gjithashtu do të analizohet edhe mënyra e rregullimit dhe zbatimit të këtij instituti në të drejtën komparative. Do të jepen të dhëna se si institucionet kompetente e zbatojnë këtë institut, do të analizohen vendime gjyqësore të shkurorëzimit të martesës dhe vendosjen e kujdestarit për fëmijët e mitur. Do të analizohet puna dhe roli i QPS-së, vendimet që jepen për kujdestarinë e fëmijëve, efekti si dhe vendimi final i gjykatës bazuar në propozimin e QPS-së dhe së fundmi efekti i këtij vendimi dhe realizimi i tij në praktikë.

Do të analizohet pozita e fëmijëve pas shkurorëzimit të prindërve dhe qëndrimi vetëm me prindin i cili e ka fituar kujdestarinë, si dhe do të jepen të dhëna statistikore cilët prindër e fitojnë kujdestarinë e fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në të drejtën komparative, do të bëhet dallimi midis legjislacionit tonë dhe të drejtës komparative.

Do të analizohet instituti i ushtrimit të së drejtës prindërore, përgjegjësisë prindërore, mbajtja e kontakteve me fëmijen, alimentacioni si dhe interesi më i lartë i fëmijës.

Do të analizohet Instituti JOINT CUSTODY (Prindëria e Përbashkët), përparësitë e këtij instituti, aplikimi i këtij instituti në të drejtën komparative, si dhe do të jepen rekomandime për harmonizimin e legjislacionit familjar të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe aplikimin e këtij instituti me qëllim të realizimit të interesit më të lartë të fëmijës.



## 2. Qëllimet e hulumtimit

Qëllimi i këtij hulumtimi është të analizohet kujdestaria e fëmijëve të mitur sipas legjislacionit të Republikës së Maqedonisë Veriore dhe sipas te drejtës komparative, për arsye se midis tyre ekzistojnë dallime të dukshme në mënyrën e rregullimit ligjor si dhe funksionimit në praktikë. Në këtë hulumtim do të analizohet se si funksionojnë institucionet kompetente që rregullojnë procedurën e kujdestarisë së fëmijëve të mitur në Republikën e Maqedonisë së Veriut, mënyrat e funksionimit të këtyre institucioneve dhe së fundmi si zbatohet kjo procedurë nga ana e prindërve, do të shihet pozita të cilën e ka fëmija prindërit e të cilit janë shkurorëzuar, raporti i fëmijës me prindin, të cilit nuk i është dhënë kujdestaria, raporti midis dy ish-bashkëshortëve (prindërve) në lidhje me rritjen, edukimin e fëmijës, dhe së fundmi do të jepen të dhëna se cili është interesi më i lartë i fëmijës .

Qëllimi që unë kam përzgjedhur pikërisht këtë temë janë fëmijët e mitur të cilët gjithmonë ndodhen në pozitë shumë të pavolitshme kur prindërit e tyre shkurorëzohen dhe mbeten gjithmonë në një udhëkryq pa asnjë zgjidhje, nuk dinë se si të reagojnë, dhe shumë shpesh këta fëmijë e përjetojnë shumë keq shkurorëzimin e prindërve të tyre duke përjetuar shqetësime të ndryshme psikologjike si: përjetimi i ankthit, traumës, stresit, agresivitetit etj.

Pra nga e gjithë kjo procedurë fëmijët janë viktimë edhe të një sistemi që nuk funksionon si duhet, por edhe viktimë të një raporti të çregulluar midis prindërve të tyre. Fëmija ndodhet në një udhëkryq që nuk e din se çfarë kahje do të marrë jeta e tij për arsye të zënkave të shumta që kanë prindërit dhe mos arritja e një kompromisi për të respektuar interesin më të lartë të fëmijës.

Duke parë gjithmonë interesat personale secili nga prindërit lufton për ta marrë kujdestarinë e fëmijës dhe atë urrejtje që e kanë brenda vetes për njëri tjetrin e manifestojnë edhe tek fëmijët. Pra kjo gjë është tepër e trishtë dhe andaj përzgjedha të hulumtoj mbi këtë temë dhe të jap mendimet e mia dhe rekomandimet se si mund të arrihet në një kompromis për të respektuar interesin më të lartë të fëmijës. Andaj duhet të bëhen reforma mbi këtë institut edhe në legjislacionin familjar të RMV-së por edhe në vetëdijësimin e qytetarëve dhe prindërve të

cilët janë në proces të shkurorëzimit të martesës për rëndësinë dhe mënyrën e sjelljes midis prindërve dhe fëmijëve.

### **3. Hipotezat**

- 1.Konfliktet që i kanë dy ish- bashkëshortët i manifestojnë tek fëmijët pas shkurorëzimit të martesës .
- 2.Prindi që e merr kujdestarinë e fëmijës e ushtron të drejtën prindërore në mënyrë të plotë kurse prindi tjetër në mënyrë të kufizuar.
- 3.Statusi financiar ndikon në vendosjen se cilit prind do i takojë fëmija.
- 4.Dhënia e kujdestarisë vetëm njërit prind e diskriminon prindin tjetër në ushtrimin e së drejtës prindërore dhe nuk plotëson interesin më të lartë të fëmijës.
- 5.Prindëria e përbashkët është mënyra më e mirë për ushtrimin e së drejtës prindërore në mënyrë të barabartë dhe të pakufizuar.
- 6.Shkurorëzimi i martesës nuk domethënë ndërprerje edhe të përgjegjësisë prindërore, prindërit duhet të përkujdesen në mënyrë të barabartë për fëmijët e tyre.

#### **4. Metodologjia e hulumtimit**

Për të arritur deri tek rezultati dhe përfundimi i këtij hulumtimi do të përdoren metoda të ndryshme të cilat do të më ndihmojnë që të pasqyrojë në mënyrën më të mire të mundshme idetë dhe të dhënat për këtë hulumtim.

Në këtë punim do të përdoren metoda të ndryshme siç janë: metoda historike, metoda normative, analiza e pëmbatjes, analiza e studimeve të rasteve individuale, metoda krahasuese metodat statistikore, intervista etj.

## 5. Rëndësia e punimit

Nga i gjithë punimi shpresoj të arrij në ngritjen e vetëdijes së të gjithë prindërve, të cilët janë shkurorëzuar ose janë në proces të shkurorëzimit të arrijnë të kuptojnë se nuk ka rëndësi që midis tyre janë prishur marrëdhëniet e tyre dhe pa marrë parasysh se nuk mundën që ta durojnë më njëri tjetrin, me fëmijët e tyre duhet të sillen në mënyrë të njëjtë për të respektuar interesin më të lartë të fëmijës dhe të arrijnë të kuptojnë se përgjegjësia prindërore dhe ushtrimi i të drejtës prindërore nuk mbaron me shkurorëzimin e martesës por vazhdon edhe pas shkurorëzimit!

Duke marrë parasysh se numri i shkurorëzimeve çdo ditë e më shumë rritet në vendin tonë si dhe nëpër botë ,e shoh të nevojshme që të trajtohet një temë e tillë dhe ti jepet më shumë rëndësi Interesit më të lartë të fëmijës në procedurën e shkurorëzimit si dhe pas saj ,për arsye se fëmijët janë më delikat dhe më të ndjeshëm gjatë gjithë kësaj periudhe dhe të gjithë sëbashku duhet ti ndihmojnë që ta kalojnë në mënyrë sa më të butë duke bërë kështu bashkëpunim midis ish -bashkëshortëve ,fëmijëve si dhe institucioneve përkatëse siç është QPS në RMV.

Duhet të arrihet në vetëdijësimin dhe në arritjen e një bashkëpunimi midis ish -bashkëshortëve për hir të interesit më të lartë të fëmijës ,të dy prindërit duhet që të kooperojnë bashkërisht duke kontribuar sa më shumë për mirërritjen,edukimin dhe kujdesin ndaj fëmijës së tyre të përbashkët , duke i lënë anash inatet dhe mllefin që e kanë ndaj njëri tjetrit sepse së fundmi ata janë të dy prindërit e asaj fëmije të mitur dhe vetëm duke u kujdesur që të dy dhe duke kontribuar që të dy mund të arrijnë rezultate shumë të mira në raport me fëmijën e tyre, për arsye se gjithmonë kur shkurorëzohen prindërit fëmijet e përjetojnë më tepër këtë situatë , duke u bërë më të ndjeshëm ,dhe duke pasur parasysh se si funksionon sistemi në RMV fëmijët janë viktimat e gjithë kësaj procedure dhe fatkeqësisht me ta luhet sikur që të jenë ” kukulla”.

## **KAPITULLI I PARË: SHKURORËZIMI I MARTESËS DHE KUJDESTARIA E FËMIJËVE**

### **1.Shkurorëzimi i martesës**

Jeta familjare ka zhvillime dhe ndryshime radikale të cilat ndikojnë shumë në vazhdimësinë e jetës bashkëshortore si dhe në harmoninë familjare , duke dhënë kështu pasoja të rënda për fëmijët si dhe për bashkëshortët.

Përderisa bashkëshortët jetojnë në harmoni nuk u pengon asgjë rreth njëri tjetrit , arrijnë të bëjnë kompromise dhe të dakordohen bashkarisht për gjithçka , nuk e kursejnë veten për asgjë , qoftë edhe kur njëri nga partnerët kontribon më së shumti në bashkësinë martesore , përderisa kanë raporte të mira me njëri tjetrin partnerëve nuk u pengon asgjë , mirëpo në momentin kur marrëdhëniet e tyre fillojnë që të acarohen dhe prishen atëherë edhe sjellja e tyre fillon që të lëkundet edhe atë fillon që tu pengojë gjithçka që bën partneri tjetër duke filluar kështu edhe një “luftë”e ashpër midis tyre dhe dihet që viktima të asaj lufte të ashpër janë fëmijët e tyre të cilët e përballojnë këtë situatë me shumë vështirësi.

Në bazë të dispozitave të nenit 6-të të Ligjit për familje te Rmv-së” Martesa është bashkësi jetësore e burrit dhe gruas e rregulluar me ligj, në të cilën realizohen interesat e bashkëshortëve, familjes dhe shoqërisë. Marrëdhëniet midis bashkëshortëve krijohen mbi vendimin e lirë të burrit dhe gruas që të lidhin martesë, mbi barazinë e tyre, respektimin e ndërsjellë dhe ndihmën reciproke.”<sup>1</sup>

Në bazë të kësaj në qoftë se marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve nuk realizohen sipas këtij parimi(koncepti) të martesës ose sipas pritshmërive të bashkëshortëve ,të njërit prej tyre ose të të dyve , në shoqëritë bashkëkohore është e lejuar që në ato raste kur martesa nuk prodhon efekte pozitive të ndërpritet me shkurorëzim si mënyrë ligjore e ndërprerjes së martesës , sipas

<sup>1</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen  
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.  
150/2015

arsyeve të përmendura në ligj si dhe në procedurë në bazë të vendimit të organit kompetent të përcaktuar me ligj.

Martesa lidhet me vullnetin e lirë të bashkëshortëve .Mirëpo bashkëshortët edhe pse e lidhin martesën me vullnetin e lirë nuk do të thotë se ata mund të kërkojnë shkurorëzim pa ndonjë shkak të justifikueshëm .Ligjvënësi me këtë qëllim të mbrojtjes së martesës dhe familjes i ka paraparë kushtet për të cilat mund të kërkohej shkurorëzimi.<sup>2</sup>

Sipas Ligjit për familje të RMV-së arsytet dhe baza për shkurorëzimin e martesës janë:

a) Marrëveshje e përbashkët midis bashkëshortëve për shkurorëzim të martesës, b) me kërkesë të njërit nga bashkëshortët martesor kur marrëdhëniet martesore janë të prishura deri në atë masë sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme ,c) kur bashkësia martesore ka pushuar më gjatë se në vit.<sup>3</sup>

Shkurorëzimi është pothuajse gjithmonë një stres i madh për fëmijët, shumica e fëmijëve nuk dëshirojnë që prindërit e tyre të shkurorëzohen (përveç rasteve kur martesa ka qenë e mbushur me konflikte intensive, agresivitet apo burime të tjera të këqija, të pa përshtatshme për fëmijët). Shkurorëzimi gjithashtu, mund të ndikojë në marrëdhëniet duke çuar në humbjen e kontaktit me njërin prind, krijon vështirësi ekonomike dhe rrit nivelin e konfliktit midis prindërve. Për gjithë këto arsye, fëmijët përjetojnë një periudhë të vështirë gjatë periudhës së shkurorëzimit. Ata janë viktimë në këtë proces dhe sipas shumë hulumtimeve që janë bërë rezultojnë se fëmijët e prindërve të shkurorëzuar kanë më së shumti probleme psikosociale , edukative dhe arsimore kundrejt fëmijëve të tjerë. Për shkak të pasojave serioze që u kanosen fëmijëve gjatë periudhës së shkurorëzimit të martesës dhe pas saj rolin kyq e luan vendimi për besim, kujdes ,ruajtje dhe edukim të fëmijës së mitur ,dhe për atë shkak ky vendim duhet që seriozisht të plotësojë interesin më të lartë të fëmijës sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve.

<sup>2</sup> Prof.dr.Abdulla Aliu,Mr.sc.Haxhi Gashi,E drejta familjare,( Prishtinë),2007,fq.159

<sup>3</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen  
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.  
150/2015)

## 1.1 Shkurorëzimi i martesës me marrëveshje

Sipas Nenit 39- të Ligjit për familje të RMV-së ” Bashkëshortët mund të shkurorëzohen me marrëveshje reciproke.

Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët të mitur ose të rritur mbi të cilët iu është shtuar e drejta prindërore, është e nevojshme të dorëzojnë marrëveshje për mënyrën e kryerjes së të drejtave dhe detyrimeve prindërore dhe për mirëmbajtjen dhe edukimin e fëmijëve.

Gjykata do të sjell vendim për shkurorëzim pas pajtimit reciprok të bashkëshortëve nëse vërtetohet se ata këtë vendim e kanë sjellë në mënyrë të lirë, serioze dhe të vendosur”<sup>4</sup>

Në kohën bashkëkohore shkurorëzimi i martesës ka pësuar një evolucion mjaft të madh dhe të rëndësishëm , duke bërë që njerëzit të vetdijësohen paksa dhe martesën ashtu sikurse e lidhin me marrëveshje ,ashtu edhe ta shkurorëzojnë atë, me marrëveshje reciproke midis të dy bashkëshortëve .

Saktë ka shkruar edhe Prof.Dr.Arta Mandro “Të dy bashkëshortët janë të bindur në faktin që marrëdhënia e tyre ka arritur në një pike të tillë që nuk mund të rindërtohet .Ata bashkërisht çmojnë se e vetmja zgjidhje për ta është që t’i japin fund kësaj lidhjeje në të cilën nuk ka vend më as për dashuri, respekt dhe mirëkuptim reciprok. Ata janë të ndërgjegjësuar që të dy se kjo bashkjetesë ligjore ka humbur qëllimin dhe dhe e ka bërë të pamundur qëndrimin e tyre si burrë e grua”<sup>5</sup>

Në këtë rast kur martesë e ka humbur qëllimin e saj dhe jeta martesore midis bashkëshortëve është bërë e padurueshme ,në rastin kur bashkëshortët kanë fëmijë duhet që të marrin parasysh interesin më të lartë të fëmijës, ku në rast se përpjekjet për pajtim midis tyre janë të pasuksesshme atëherë të vendosin bashkërisht për gjithçka që ka të bëjë për të mirën e fëmijës

<sup>4</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen  
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.  
150/2015)

<sup>5</sup> A.Mandro-E drejta Familjare,Tiranë,Nëntor,2009



duke marrë parasysh mirrëritjen, edukimin dhe përkujdesin ndaj fëmijës ta bëjnë të dy bashkëshortët me marrëveshje paraprake.

Shkurorëzimi i martesës me marrëveshje është mënyra më e mirë për të prishur një martesë e cila nuk prodhon më efekte pozitive ,kur nuk ka mundësi që bashkëshortët të jetojnë në një bashkësi jetësore të përbashkët dhe kur mund të arrijnë që të marrin këtë vendim në mënyrë të qetë duke marrë parasysh fëmijën e mitur që e kanë sëbashku atëherë gjithçka është më e lehtë dhe më e sigurtë dhe më ekonomike, gjithashtu është mënyra më e shpejtë dhe duke marrë parasysh se kur nuk ka pengesa gjithçka përfundon që në seancën e parë.

Marrëveshjen e përbashkët për shkurorëzim të martesës, bashkëshortët e citojnë në përpilimin e propozimit për shkurorëzimin e martesës në bazë të marrëveshjes së përbashkët deri tek gjykata kompetente. Këtë pëlqim të bashkëshortëve martesor ligjvënësi I RMV-së e kushtëzon me përpilimin e marrëveshjes, planit për mënyrën e ushtrimit të së drejtës prindërore , detyrimeve , mbajtjen ,përkujdesin dhe edukimin e fëmijëve , e cila duhet të jetë e përpiluar dhe e ndarë në mënyrë të qartë .Kjo marrëveshje duhet të inicohet me shkrim ose gojarisht në procesverbalin e gjykatës kompetente . Në bazë të vlerësimit të kësaj marrëveshjeje gjykata është e obliguar të kërkojë(merr) mendim nga Qendra për punë sociale se a është kjo marrëveshje për interesin më të lartë të fëmijës.<sup>6</sup>

Në rast se marrëveshja e përpiluar dhe e propozuar nga ana e të dy partnerëve nuk përmbush interesin më të lartë të fëmijës atëherë QPS do të sjell mendim dhe propozim tjetër për , kujdestarinë e fëmijës se kujt do i takojë dhe mënyra se si do të mbahen kontaktet me prindin tjetër me të cilin nuk jeton fëmija.

Zakonisht tek ne kjo mënyrë e shkurorëzimit është më e rallë ,sepse të pakta janë rastet ku me marrëveshje mund të shkurorëzohet martesja si dhe të bëhet marrëveshje dhe plan për mënyrën e ushtrimit të së drejtës prindërore,për edukimin,mirëqënien dhe detyrimet ndaj fëmijëve të mitur si dhe për mbajtjen ose alimentacionin.

<sup>6</sup>Лилјана Спировиќ Трпеновска,Дејан Мицковиќ и Ангел Ристов(2013),Семејно Право,Скопје,Блесок,стр.140

## **1.2.Shkurorëzimi i martesës për shkak të marrëdhënieve të prishura dhe jetës së padurueshme ndërmjet bashkëshortëve**

Sipas Nenit 40- të Ligjit për familje të RMV-së “Bashkëshortët mund të shkurorëzohen me kërkesë të njërit prej bashkëshortëve nëse marrëdhëniet martesore janë deri në atë masë të prishura sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme.”<sup>7</sup>

Në rast se bashkëshortët nuk mundën që të mirren vesh sëbashku për ta shkurorëzuar martesën me marrëveshje të përbashkët, atëherë njëri prej bashkëshortëve inicon Padi për shkurorëzim të martesës për shkak të marrëdhënieve të prishura dhe jetës së padurueshme . Për arsye se marrëdhëniet ndërmjet bashkëshortëve janë deri në atë masë të prishura sa që jeta e përbashkët është bërë e padurueshme dhe si e tillë nuk mund të vazhdohet i propozojnë gjykatës që ta shkurorëzojë martesën në bazë të dispozitës së lartëpërmendur.

Shkurorëzimi i martesës për shkak të marrëdhënieve të prishura mund të jetë i nxitur nga disa arsye konkrete dhe rrethana të cilat Ligji i familjes në RMV nuk i citon ,por vetëm thekson në mënyrë të gjërë se me çfarë baze mund të kërkohej shkurorëzim me inicim të padisë nga ana e njërit prej bashkëshortëve.Gjithashtu ,ekzistojnë situata kur është e vështirë që të kuptohen rrethanat e caktuara të cilat mund të nxisin deri në inicimin e padisë për shkurorëzim,por në qoftë se martesë nuk e realizon më qëllimin e saj ,atëherë insistimi për vërtetimin e shkaqeve për shkurorëzim mund të sjellin deri në mosdurim ndërmjet bashkëshortëve, e cila nuk ka efekte pozitive sidomos në qoftë se bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët ,për arsye se në këtë rast kontaktet e tyre nuk përfundojnë me shkurorëzimin e martesës.Për këtë arsye ,për shkak të mbrojtjes së interesit më të lartë të fëmijës, më së miri është që ata të kenë bashkëpunim dhe të arrijnë të kenë mirëkuptim dhe korrektektësi për arritjen e kujdesit të përbashkët për fëmijët.<sup>8</sup>

<sup>7</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen  
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.  
150/2015)www.akademika.com

<sup>8</sup>Проф-Д-Р КИРИЛ ЧАВДАР ,Д-Р ЦВЕТАНКА СИЉАНОСКА КОСТАНДИНОВА,КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА СЕМЕЈСТВО,(СКОПЈЕ)Академик, 2013.стр.138.

Në qoftë se në një martesë fillon të zbehet dashuria ,zënkat janë të shpeshta për shkak të karaktereve të ndryshme me njëri tjetrin , atëherë kur jeta e përbashkët është e padurueshme është më mirë që kjo martesë të përfundojë ,mirëpo në rastin kur bashkëshortët kanë fëmijë të përbashkët është mirë që të munden ta kontrollojnë mllëfin dhe inatin që e kanë midis tyre dhe të mund të bëjnë kompromis për hir të interesit më të lartë të fëmijës ,sepse marrëdhëniet e prishura midis bashkëshortëve ,zënkat dhe sjellja e tyre arrogante ndaj njëri tjetrit mund të ndikojnë keq në psikologjinë e fëmijës si dhe në edukimin,mirëmbajtjen dhe kujdesin ndaj fëmijës.

Për arsye se fëmija sidomos gjatë kësaj periudhe të shkurorëzimit është shumë emocional , partnerët duhet që të kenë kujdes dhe të mos veprojnë me gjakftohtësi duke konkuruar me inat me njëri tjetrin duke bërë “luftë” se kush ka më shumë pushtet dhe kush do të arrijë që të “fitojë” kujdestarinë e fëmijës ,dhe në këtë mënyrë arrijnë të “hakmerren”,por harrojnë që në këtë mënyrë më së shumti e lëndojnë fëmijën e tyre e cila është preh dhe viktimë e kësaj “luftime”.Fëmijën e tyre e përdorin për tu hakmarrë ndaj partnerit tjetër duke mos i lënë hapësirë dhe mundësi që të zhvillojë kontakte me prindin me të cilin nuk jeton fëmija.

### **1.3 Shkurorëzimi i martesës për shkak të pushimit faktik të jetesës bashkëshortore më gjatë se një vit**

Sipas Nenit 41- të Ligjit për familje të RMV-së “Njëri nga bashkëshortët mund të kërkojë shkurorëzim nëse bashkësia martesore faktikisht ka përfunduar më gjatë se një vit.”<sup>9</sup>

Kjo është mënyra dhe baza e tretë sipas Legjislacionit familjar të RMV-së , e cila zakonisht në praktikë rezulton si më pak e përdorur ,dhe zakonisht rastet e tilla janë më të lehta për tu konstatuar dhe për tu dhënë zgjidhje problemeve që dalin pas shkurorëzimit të martesës edhe atë sa i përket kujdestarisë së fëmijëve të përbashkët .

Ligjvënësi i jep mundësi bashkëshortëve që sipas kësaj mënyrë të shkurorëzojnë martesën kur jetesa bashkëshortore e përbashkët ka përfunduar faktikisht , pra njëri nga bashkëshortët e ka lëshuar shtëpinë e përbashkët në të cilën kanë jetuar sëbashku ku i kanë plotësuar nevojat e martesës dhe të familjes , dhe pas saj nuk kanë patur më kontakte dhe nuk i kanë përmbushur të drejtat dhe detyrimet që dalin nga martesa dhe kjo ndërprerje në qoftë se ka zgjatur më shumë se një vit atëherë njëri prej bashkëshortve pa marrë parasysh partneri i cili e ka ka braktisur shtëpinë e përbashkët ose partneri tjetër mund të inicojë padi për shkurorëzim të martesës për shkak të pushimit faktik të jetës bashkëshortore më gjatë se një vit.

Mirëpo mund të ekzistojnë edhe raste kur bashkëshortët mund të jetojnë në një çati mirëpo në dhoma të ndara dhe nuk i plotësojnë detyrimet dhe të drejtat që dalin nga martesa,nuk bashkëpunojnë sëbashku atëherë ajo martesë llogaritet si “martesë e vdekur”<sup>10</sup>

Zakonisht këto raste nuk janë shumë konfliktuoze dhe kontestuese sepse gjithçka është lehtë e vërtetueshme dhe në këto raste zakonisht fëmija mbetet nën edukim ,mbrojtje dhe kujdestari të prindit me të cilin ka qenë deri në përfundimin e afatit 1 vjeçar të pushimit faktik të martesës.

<sup>9</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2015)

<sup>10</sup> Љ.Спировиќ-Трпеновска,учебник,стр.133-134

Si pushim faktik të bashkësisë martesore nuk mund të konsiderohet në rast se njëri prej bashkëshortëve është larguar për shkak të arsimimit, avancimit ,profesionit ose pamundësisë ekonomike largimimi për punë të përkohshme jashtë ,për të cilën janë marrë vesh së bashku të dy bashkëshortët ,edhe pse ata nuk jetojnë faktikisht në një bashkësi martesore të përbashkët por kontaktet e tyre dhe bashkëpunimi nuk kanë përfunduar por vazhdojnë njëjtë edhe pse faktikisht njëri prej bashkëshortëve ndodhet në vend tjetër, në këtë rast është e qartë se martesë i përmbush nevojat dhe detyrat që dalin prej saj .<sup>11</sup>

<sup>11</sup> Проф-Д-Р КИРИЛ ЧАВДАР ,Д-Р ЦВЕТАНКА СИЉАНОСКА КОСТАНДИНОВА,КОМЕНТАР НА ЗАКОНОТ ЗА СЕМЕЈСТВО,(СКОПЈЕ)Академик, 2013.стр.138.

#### 1.4.Kujdestaria e fëmijëve

Sipas Legjislacionit familjar të RMV-së Kujdestaria e fëmijëve të mitur pas shkurorëzimit të martesës i jepet në mënyrë tradicionale vetëm njërit prind , kurse prindi tjetër ka të drejtë për mbajtjen e marrëdhënieve personale dhe kontakteve direkte me fëmijën e mitur edhe atë në bazë të vendimit shtesë që do e sjellë qendra për punë sociale për mënyrën dhe realizimin e kontakteve ndërmjet prindit të cilit nuk i është dhënë kujdestaria dhe fëmijës.Gjithashtu prindi i cili nuk e ka kujdestarinë e fëmijës obligohet që të paguajë alimentacioninin e caktuar nga ana e gjykatës për fëmijën.

Sipas Nenit 80 të legjislacionit familjar të RMV-së “Me aktgjykimin me të cilin zgjidhet martesa, gjykata do të vendos për kujdesin, edukimin dhe mirëmbajtjen e fëmijëve të përbashkët.

Nëse prindërit nuk janë marrë vesh për këtë ose nëse marrëveshja e tyre nuk i përgjigjet interesave të fëmijës, gjykata, pasi që të merr mendimin nga qendra për punë sociale dhe pasi t'i shqyrtojë rrethanat, do të vendos nëse fëmijët do të mbeten për kujdes dhe edukim te njëri prind ose disa do të mbeten te nëna, ndërsa disa te babai ose të gjithë do t'i besohen ndonjë personi të tretë ose ndonjë institucioni.

Prindi, të cilit nuk i janë besuar fëmijët ka të drejtë të mbajë raporte personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me to, nëse gjykata nuk përcakton ndryshe duke marrë parasysh interesat e fëmijëve.

Gjykata, pas kërkesës të njërit nga bashkëshortët e ndarë ose qendrës për punë sociale, do ta ndryshojë vendimin për kujdes dhe edukim të fëmijëve dhe për raportet e bashkëshortëve të ndarë ndaj fëmijëve të tyre të përbashkët, nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara”.<sup>12</sup>

Pikërisht problemi kryesor që parashtrohet pas shkurorëzimit të martesës është vendimi për besim,edukim dhe mbajtje të fëmijëve.Kjo ka të bëjë me fëmijët e mitur të përbashkët ,si dhe fëmijëve të tjerë madhorë cilëve u është vazhduar e drejta prindore.Në qoftë se prindërit arrijnë që të bëjnë marrëveshje rreth mënyrës të ushtrimit të të drejtës prindërore pas

<sup>12</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen  
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2015)

shkurorëzimit të martesës gjykata do ta pranojë marrëveshjen e tyre në qoftë se ajo është në interesin më të lartë të fëmijës (dihet se këto raste rezultojnë të pakta në praktikën tonë). Vendimi më i rëndësishëm rreth vlerësimit të rrethanave në bazë të secilit rast konkret në bazë të legjislacionit tonë familjar i është besuar Qendrës për punë sociale. Pa marrë parasysh se kujt nga të dy prindërve do ti jepen fëmijët në kujdestari e drejta në mbajtjen e tyre është e përbashkët. Çaktimi i lartësisë së mbajtjes ose alimentacionit bëhet në bazë të të ardhurave dhe në bazë të nevojave të fëmijëve.<sup>13</sup>

Me institutin e kujdestarisë së fëmijëve të mitur pas shkurorëzimit të martesës në praktikë shfaqen edhe të gjitha problemet dhe konfliktet të cilat i kanë ish bashkëshortët në raport të ndërsjelltë midis tyre si dhe në raport me fëmijën, ku prindi i cili e ka kujdestarinë e fëmijës të drejtën prindore e ushtron në mënyrë të plotë kurse prindi tjetër e ushtron në mënyrë të pjesshme ose të kufizuar, dhe e gjitha kjo rezulton në dëm të fëmijës, ku fëmija shfaqet “viktimë” i raportit të keq që e kanë prindërit e tij, sepse fëmija gjithmonë është viktimë në luftën që e luajnë të dy prindërit.

Pikërisht në bazë të sistemit tonë i cili nuk funksionon siç duhet dhe në bazë të mos bashkëpunimit të të dy prindërve për të plotësuar interesin më të lartë të fëmijës, bashkarisht e “vrasin” çdo ditë atë fëmijë i cili gjatë periudhës së shkurorëzimit të prindërve të tij si dhe pas saj gjatë gjithë periudhës derisa të rritet e vuan tepër ndarjen e prindërve të tij, dhe për këtë prindërit duhet që të arrijnë një kompromis midis tyre duke mos shikuar vetëm interesat personale por të lënë anash inatet dhe të shohin të plotësojnë interesin më të lartë të fëmijës, sepse në praktikë prindi i cili e ka kujdestarinë e fëmijës të drejtën prindërore e ushtron vetëm, edhe atë duke mos i dhënë hapësirë dhe mundësi prindit tjetër të kyçet në kujdesin, edukimin dhe mirërritjen e fëmijës, por vetëm e detyron atë të paguajë alimentacionin dhe asgjë më shumë. Por pikërisht ndonjëherë prindi i cili nuk e ka kujdestarinë dhe ka të drejtë vetëm në kontakte me fëmijën sipas vendimit që e sjellë QPS, mendon se e ka kryer obligimin dhe e ka ushtuar të drejtën prindore vetëm duke e paguar shumën e alimentacionit të caktuar.

<sup>13</sup> Доц.д-р Симеон Цветановски, М-р Билјана Тодорова, Семејно и Наследно право, Скопје, 2009, стр.66

Me shkurorezim përfundon vetëm bashkësia martesore midis partnerëve dhe nuk përfundon edhe e drejta prindore , pra pa marrë parasysh se partnerët janë shkurorezuar, ata bashkarisht duhet ta ushtrojnë të drejtën prindore ,sëbashku duhet të marrin të gjitha vendimet për fëmijën, së bashku duhet të kujdesen ,së bashku duhet të marrin çdo veprim që ka të bëjë me interesin më të lartë të fëmijës dhe kjo mund të arrihet vetëm me marrëveshje dhe me kompromis midis të dy prindërve .

Sipas hulumtimit të bërë nga ana e Avokatit të Popullit në RMV për vitin 2014-2016 ku janë analizuar procedurat gjyqësore dhe procedurat në Qendrën për Punë Sociale në 27 Komuna të RMV-së rezulton se: numri i përgjithshëm i procedurave për dhënien e kujdestarisë së fëmijëve të mitur në bazë të marrëveshjes së prindërve ka qenë gjithsej 704 edhe atë : në vitin 2014- 234 raste,në vitin 2015- 257 raste dhe në vitin 2016- 213 raste.

Kurse numri i përgjithshëm i procedurave për dhënien e kujdestarisë së fëmijëve të mitur në bazë të padisë së ngritur nga njëri prej bashkëshortëve është gjithsej 1836 edhe atë: në vitin 2014- 681 raste, në vitin 2015- 583 raste dhe në vitin 2016-572 raste.

Në bazë të kësaj shihet qartë se numri i procedurave të inicuar është dukshëm më i madh në bazë të padisë për arsye se prindërit nuk arrijnë që të bëjnë marrëveshje për kujdestarinë e fëmijëve dhe për të respektuar interesin më të lartë të tij.

Prej analizës të të dhënave të marra nga gjykata për këtë hulumtim për periudhën prej vitit 2014-2016 rezultuan se kujdestaria e fëmijëve të mitur në të shumtën e rasteve i është dhënë nënës dhe më pak babait edhe atë: në 2.529 raste i është dhënë nënës, kurse në 503 raste i është dhënë babait edhe atë : në vitin 2014 kujdestaria i është dhënë nënës në 854 raste kurse babait në 196 raste , në vitin 2015 në 851 raste i është dhënë nënës kurse në 184 raste babait dhe në vitin 2016 në 824 raste i është dhënë nënës kurse në 123 raste i është dhënë babait.<sup>14</sup>

<sup>14</sup> <http://ombudsman.mk/upload/Posebni%20izvestaj/2017/Poseben%20izvestaj-Licni%20kontakti-2017.pdf>  
publikuar më Dhjetor,2017



### 1.5. E drejta prindërore

E drejta prindërore ,së bashku me të drejtën martesore dhe të drejtën e kujdestarisë ,përbën pjesë të së drejtës familjare , dhe në vitet e fundit pikërisht e drejta prindërore bëhet pjesa më e rëndësishme e së drejtës familjare.<sup>15</sup>

Objekt i të drejtës prindërore janë:

1. Rregullimi i marrëdhënieve prindore
2. Të drejtat dhe detyrimet e prindërve,fëmijëve dhe të afërmeve familjar
3. Ushtrimin e të drejtës prindore
4. Mbarimi dhe Vazhdimi i të drejtave dhe detyrimeve prindore.

Sipas Nenit 44 të Ligjit familjar të RMV ” Të drejtën prindërore e përbëjnë të drejtat dhe detyrimet e prindërve që të kujdesen për personalitetin, të drejtat dhe interesat e fëmijëve të tyre të mitur dhe fëmijëve mbi të cilët është vazhduar e drejta prindërore.<sup>16</sup>

E drejta prindërore me të cilën nënkuptohen të drejtat dhe detyrimet e prindërve ,mbaron ose ndërpritet me arritje të moshes madhore të fëmijës,me lidhjen e martesës së fëmijës para moshes madhore,me adoptim dhe me vdekje.<sup>17</sup>

Në legjislacionin familjar të RMV-së duhet të bëhen edhe disa ndryshime në terminologji edhe atë e drejta prindore të ndryshohet me termin përgjegjësia prindërore, ky term pëdoret në legjislacionet bashkëkohore siç janë p.sh Franca, Britania e Madhe etj, gjithashtu ky term parashihet edhe në Konventën për të drejtat e fëmijëve të v.1989. Termi e drejta prindore më së shumti na asocon në një marrëdhënie klasike dhe tradicionale ku prindërit kanë vetëm të

<sup>15</sup> Лилјана Спировиќ Трпеновска,Дејан Мицковиќ и Ангел Ристов(2013),Семејно Право,Скопје,Блесок,стр.172

<sup>16</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen  
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2015

<sup>17</sup> Лилјана Спировиќ Трпеновска,Дејан Мицковиќ и Ангел Ристов(2013),Семејно Право,Скопје,Блесок,стр.173

drejta dhe nuk haset aspak përgjegjësia prindërore e cila është baza kryesore për përmbushjen e interesit më të lartë të fëmijës.

Termi e drejta prindore nuk e shpreh konceptin më të ri të përshtatshëm për marrëdhëniet ndërmjet prindërve dhe fëmijëve ,për arsye se ajo implementon se prindërit kanë të drejta dhe autorizime ne raport me fëmijët,të cilët në këtë aspekt trajtohen si subjekte pasive dhe të varura.Në legjislacionet bashkëkohore pranohet tendeca tërësisht e kundërt nga e jona ,e cila themelohet në bazë të përgjegjësisë së prindërve kundrejt fëmijëve të tyre ,të cilët më nuk llogariten si subjekte pasive për mbrojtje por llogariten si subjekte aktive të së drejtës .<sup>18</sup>

Sipas Nenit 45 të Ligjit familjar të RMV ” E drejta prindërore iu takon nënës dhe babait në mënyrë të barabartë.

Nëse njëri nga prindërit është i vdekur ose nuk është i njohur ose i është marrë e drejta prindërore ose nëse për arsye tjera është penguar ta ushtrojë të drejtën prindërore, të drejtën prindërore e kryen prindi tjetër.<sup>19</sup>

Prindëria vazhdon edhe pas shkurorëzimit të martesës ,pa marrë parasysh se dashuria midis të dy partnerëve ka përfunduar ,asesi nuk duhet të lejohet që ushtrimi i të drejtës prindore të kufizohet pas shkurorëzimit , sepse dashuria për fëmijët nuk mbaron me përfundimin e martesës , përgjegjësia prindore vazhdon , për prindin fëmija mbetet përsëri në vendin e njejtë që ka patur edhe gjatë martesës dhe pikërisht për këtë duhet që të vetëdijësohen të dy partneret duke mos dëmtuar njëri tjetrin dhe fëmijën njëkohësisht duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet sëbashku për të plotësuar interesi më të lartë të fëmijës .

<sup>18</sup> Лилјана Спировиќ Трпеновска,Дејан Мицковиќ и Ангел Ристов(2013),Семејно Право,Скопје,Блесок,стр.173/4

<sup>19</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2015)

## 1.6 Të drejtat dhe detyrat e prindërve dhe fëmijëve

Pra përgjegjësia prindore është e pandarë iu takon të dy prindërve në mënyrë të barabartë si nënës ashtu edhe babait .Të drejtat dhe detyrimet e prindërve në raport me fëmijën janë të barabarta ata sëbashku duhet të kujdesen për personalitetin e fëmijës, për interesat e fëmijës , për mirrëritjen e fëmijës,për edukimin,për arsimimin.

Prindërit kanë të drejtë dhe obligim që t'i mirëmbajnë fëmijët e tyre të mitur, të kujdesen për jetën e tyre dhe për shëndetin e tyre, t'i përgatisin për jetë dhe punë të pavarur dhe të kujdesen për edukimin, arsimimin dhe aftësimin e tyre profesional.

Fëmija ka të drejtë për kujdes nga prindërit e tij, të mbrohet jeta dhe shëndeti i tij, të jetë i aftë për jetë dhe punë të pavarur, t'i sigurohen kushte optimale për edukimin, shkollimin dhe aftësimin e tij profesional, varësisht nga kushtet e familjes.<sup>20</sup>

Përgjegjësia prindërore realizohet duke u kujdesur prindërit për fëmijën , duke marrë të gjitha veprimet për të përmbushur interesin më të lartë të fëmijës ku fëmija duhet të jetë në shkallën parësore për të dy prindërit ,fëmija ka të drejtë të shkollohet në një shkollë të mirë, të jetojë në një ambient të qetë dhe të shëndoshë , me harmoni, të vazhdojë jetën duke iu plotësuar kushtet minimale për jetesë ,por në qoftë se të dy prindërit kanë më shumë të ardhura tia mundësojnë sëbashku jetesën më të mire, duhet të kujdesen për mirëqënien e fëmijës ,por pavarësisht të gjithave duhet që të kalojnë kohë të mjaftueshme me njëri tjetrin për të plotësuar anën emocionale ,sepse fundja prindërit kanë përgjegjësi për fëmijët e tyre dhe gjithçka që do të kultivojnë ata do t'i korrë fëmija e tyre ,sepse zakonisht fëmijët e ndjekin shembullin e prindërve të tyre , dhe në qoftë se prindërit nuk kujdesen mirë për ta ose i malltretojnë duke i bërë të përjetojnë ankthe dhe strese, ekzistojnë gjasa që edhe ai fëmijë kur të rritet të ndjek të njejtin shembull siç kanë reaguar prindërit me të.

<sup>20</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen  
("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2015)neni46

Sipas nenit 47 të Ligjit për familje të RMV-së " Fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre.

Fëmijët e mitur mund të jetojnë të ndarë nga prindërit e tyre vetëm kur kjo është në interes të drejtpërdrejt të fëmijëve ose kur kjo është në interes të përbashkët të fëmijëve dhe prindërve. Fëmija ka të drejtë të mbajë marrëdhënie dhe kontakte të drejtpërdrejta personale me prindin me të cilin nuk jeton.

Prindi me të cilin fëmija nuk jeton ka të drejtë dhe obligim të mbajë raporte personale dhe kontakte të drejtpërdrejta me fëmijën e vet.

Fëmijët e mitur kanë të drejtë të mbajnë kontakte të drejtpërdrejta me prindërit dhe familjarët tjerë të afërt të prindit i cili ka vdekur, prindit të cilit i është marrë e drejta prindërore ose i cili për arsye tjera është penguar ta ushtrojë të drejtën prindërore.”<sup>21</sup>

Pra siç e cekëm dhe më lartë fëmijët e mitur kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre ,kjo është edhe e drejtë themelore e garantuar sipas Konventës për të drejtat e fëmijëve, ky parim në vete nënkupton edhe obligim,sepse prindërit duhet t’ia mundësojnë fëmijës që të jetojnë sëbashku ,mirëpo në qoftë se prindërit shkurorëzohen nuk domethënë se fëmijët duhet të jetojnë ndaras ,por pikërisht për këtë duhet të kujdesen të dy prindërit në lidhje me raportin që do të themelojnë sëbashku dhe mënyrën se si do e bëjnë të ndihen fëmijën e tyre. Fëmijët kanë të drejtë të jetojnë me prindërit e tyre dhe prindërit përgjegjësinë e tyre prindore ta ushtrojnë në mënyrë të barabartë,sepse sëbashku mund të kujdesen më mirë për fëmijën dhe për t’ia plotësuar nevojat e fëmijës duke u kujdesur për personalitetin,shëndetin ,edukimin etj. Gjithashtu edhe mbajtja e fëmijës bie në barrë të të dy prindërve edhe pas shkurorëzimit të martesës pa marrë parasysh se gjykata i cakton shumën dhe alimentacionin për ta paguar prindi me të cilin nuk jeton fëmija .

<sup>21</sup> Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për familjen ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2015)

## 1.7 Marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve

Prindërit dhe fëmijët duhet të kenë raporte të afërta dhe marrëdhënie të pakufizuar për të përmbushur interesin më të lartë të fëmijës si dhe për të përmbushur parimet për një familje të shëndoshë ,sepse pa marrë parasysh se prindërit janë të shkurorëzuar përsëri për fëmijën ata sëbashku përbëjnë familjen e tij dhe për këtë duhet që të bëhet tepër kujdes se çfarë marrëdhënie ose çfarë raporte do të themelohen pikërisht pas shkurorëzimit të martesës . Sepse deri atëherë për partnerët nuk ka patur shumë rëndësi se kush ka kontribuar më shumë , kush është kujdesur më shumë, qoftë emocionalisht qoftë financiarisht ,pra e gjithë problemi rreth marrëdhënieve midis prindërve dhe fëmijëve shfaqet pas shkurorëzimit të martesës sepse në legjislacionin tonë gjykata me aktgjykimin që e shkurorëzon martesën vendos se cilit prind do t'ia besojë në mbajtje,kujdes,edukim fëmijën e mitur,kurse prindit tjetër do t'i caktojë vetëm te drejtën në mbajtje të kontakteve personale me fëmijën ,dhe më pas qendra për punë sociale me aktvendim do të jep të dhëna më të hollësishme se si do të zhvillohen këto kontakte,si do të jetë dinamika dhe kohëzgjatja. Me këtë në mënyrë direkte diskriminohet prindi tjetër i cili nuk e ka kujdestarinë e fëmijës, sepse në të shumtën e rasteve i kufizohet ushtrimi i të drejtës prindore në mënyrë direkte , sepse p.sh ta shohësh fëmijën dy herë në muaj edhe atë për disa orë në hapësirat e Qendrës për Punë Sociale është tepër e trishtë dhe aspak në favor të interesit më të lartë të fëmijës dhe prindit me të cilin nuk jeton fëmija.Në këtë rast marrëdhënia midis prindërve dhe fëmijëve nuk është e barabartë dhe mund të sjellë shumë pasoja në zhvillimin e personalitetit të fëmijës .

Një fëmijë dhe prindërit e tij kanë të drejtë të mbajnë marrëdhënie të rregullta me njëri tjetrin ,këto marrëdhënie mund të kufizohen ose të përjashtohen vetëm kur janë në interes të fëmijës.<sup>22</sup>

Pra asgjë nuk mund t'i ndalojë prindërit që të mos kenë raporte dhe marrëdhënie të rregullta me fëmijët e tyre kur kjo nuk e pengon interesin më të lartë të fëmijës, por përkundrazi mund të jep rezultate tepër të shkëlqyera vetëm duke patur një marrëdhënie të singertë dhe korrekte

<sup>22</sup> A.Mandro-E drejta Familjare,Tiranë,Nëntor,2009 fq.444

midis të dy partnerëve të shkurorëzuar që në fakt janë prindërit e fëmijës dhe midis fëmijës së tyre ,pra raporti midis prindit dhe fëmijës me të cilin nuk jeton fëmija duhet të jetë i barabartë me raportin që e ka prindi i cili e ka kujdestarinë e fëmijës , dhe për hir të interesit më të lartë të fëmijës të arrijnë të dy ish bashkëshortët të kenë një marrëdhënie korrekte dhe bashkarisht të ndërmarrin vendime dhe të vendosin për më të mirën e fëmijës së tyre ,sepse në qoftë se ata të dy do të arrijnë të kenë nje raport siç duhet kjo do të manifestohet edhe tek fëmija dhe do të ndikojë pozitivisht në personalitetin e tij. Për të tejkuar pozitën e vështirë në të cilën ndodhet pasi janë shkurorëzuar prindërit e tij.

## **KAPITULLI I DYTË: PROCEDURA GJYQËSORE**

### **2.Procedura në kontestet martesore**

Kontestet martesore janë konteste që kanë të bëjnë me statusin martesor,në të cilat kërkohet që të ndryshohet statusi ekzistues i bashkëshortëve me shkurorëzim,ose në të cilat kërkohet që të vërtetohet se ekziston ,respektivisht nuk ekziston martesë.Në procedurë kontestimore gjykata shqyrton dhe vendos edhe për kontestet nga marrëdhëniet familjare. Procedurat e veçanta kontestimore në kontestet familjare në RMV janë rregulluar me Ligjin për familjen të vitit 1992. Me këtë ligj rregullohen procedurat e veçanta kontestimore në kontestet familjare edhe atë: a) procedurën në kontestet martesore,b) procedurën në kontestet për vërtetimin dhe kontestimin e atësisë dhe amësisë,c) procedurën në kontestet për besimin e fëmijëve në ruajtje dhe edukim,ç) procedurën në kontestet për ushqimi dhe gjatë zgjedhjes së këtyre kontesteve do të vepohet sipas rregullave të procedurës së përgjithshme kontestimore.<sup>23</sup>

Në procedurat për kontestet martesore sipas dispozitave të Ligjit për familje vlejné karakteristikat siç janë: Urgjenca e procedurës , gjykim kolegjal , përjashtim i publikut në seancën për pajtim dhe në seancën për shqyrtim kryesor , kufizimin e dispozicionit të palëve, mbrotja e privatësisë , lejimi i revizionit.<sup>24</sup>

Kompetente për shkurorëzimin e martesës do të jetë gjykata me kompetencë vendore të përgjithshme, procedura inicohet me padi nga bashkëshortët edhe atë mënyrat i kemi përmendur më lartë .Nëse bashkëshortët kanë fëmijë të mitur të përbashkët ose fëmijë madhor mbi të cilët u është vazhduar e drejta prindore,procedura është urgjente,dhe gjykata do t'i zgjedh ato me prioritet.

<sup>23</sup> J.Arsen E drejta procedurale civile.L.1, Edrejta Kontestimore/Arsen Janevski,Tatjana Zoroska-Kamilovska:Përktheu Emine Zendeli,Nagip Zendeli-Tetovë-Univesiteti i Evropës Juglindore,2011 f.445

<sup>24</sup> Кирил Чавдар, Цветанка Сиљаноска - Костадиновска. Коментар на закон за семејното право: коментари, судска практика, предметен регистар, примери за практична примена, придружни прописи и литература. Скопје: Академик, 2013.

Pas pranimit të padisë ose propozimit për marrëveshje reciproke midis bashkëshortëve, dhe para dërgesës së padisë të paditurit, do të tentohet procedura për pajtim të bashkëshortëve, kur palët kanë fëmijë të përbashkët procedurën për pajtim e zbaton Qendra për Punë Sociale, edhe atë QPS është e obliguar që më së voni në afat prej 3 muajsh nga pranimi i njoftimit të përfundojë procedurën për pajtimin e bashkëshortëve.<sup>25</sup>

Në qoftë se procedura për pajtim është e pasuksesshme atëherë kryetari i këshillit do të caktojë seancë për shqyrtim kryesor dhe të paditurit ia dërgon padinë për shkurorëzim, në qoftë se palët kanë inicuar padi për shkurorëzim me marrëveshje reciproke palët përveç marrëveshjes për shkurorëzim, është e nevojshme që të parashtrojnë marrëveshje për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindore për mbajtjen dhe edukimin e fëmijëve, kjo marrëveshje parashtohet me shkrim ose gojarisht në procesverbalin para gjykatës kompetente të shkallës së parë, por në qoftë se të dy palët nuk arrijnë që të merren vesh për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe detyrimeve prindore edhe pas seancës së pajtimit atëherë qendra për punë sociale jep propozim se kujt do t'ia besojë në ruajtje, mbajtje, dhe edukim të fëmijëve duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës.<sup>26</sup>

Gjatë procedurës kontestimore për shkurorëzimin e martesës gjykata me aktvendim mund të përcaktojë masa të përkohshme për sigurimin e mbajtjes së fëmijëve të përbashkët dhe besimin e tyre në ruajtje dhe edukim. Në qoftë se kjo është në interesin më të lartë të fëmijës dhe këto masa zgjasin deri në përfundimin të procedurës për shkurorëzim, por gjykata me detyrë zyrtare ose me kërkesë të palëve mund ti ndryshojë.<sup>27</sup>

Me aktgjykimin me të cilin shkurorëzohet martesa gjykata vendos përveç shkurorëzimit të martesës edhe se kujt nga prindërit do ia jep në kujdetari fëmijët e përbashkët (pas marrjes së

<sup>25</sup> J. Arsen E drejta procedurale civile. L.1, Edrejta Kontestimore/Arsen Janevski, Tatjana Zoroska-Kamilovska: Përktheu Emine Zendeli, Nagip Zendeli-Tetovë-Univesiteti i Evropës Juglindore, 2011 f.445

<sup>26</sup> Кирил Чавдар, Цветанка Сиљаноска - Костадиновска. Коментар на закон за семејното право: коментари, судска практика, предметен регистар, примери за практична примена, придружни прописи и литература. Скопје: Академик, 2013

<sup>27</sup> По ату



mendimit të dhënë nga qendra për punë sociale dhe pas shqyrtimit të raportit) , lejon prindin tjetër që të mbajë kontakte direkte me fëmijën kurse QPS do të vendosë dinamikën dhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve , si dhe e ngarkon prindin tjetër të cilit nuk i jepet kujdestaria e fëmijëve në dhënien e alimentacionit për fëmijët dhe në qoftë se është e nevojshme edhe për mbajten ndaj ish -bashkëshortit .

Vendimin përfundimtar për mbajtjen e fëmijëve për ruajtje dhe edukim pas shkurorëzimit të martesës e sjell gjykata duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës . Mirëpo në të shumtën e rasteve në praktikë gjykata e sjell vendimin e njejtë sipas propozimit që ka bërë qendra për punë sociale ,dhe shumë rallë vendos ndryshe nga ai vendim.

Si dhe ngarkon prindin tjetër të cilit nuk i jepet kujdestaria e fëmijëve që të paguajë alimentacion për secilin fëmijë veç e veç dhe zakonisht në praktikë atë e ngarkon me një shumë qesharake prej 2000 denarësh që nuk janë të mjaftueshme për asgjë dhe me këtë ngarkesë njëri prind që e ka kujdestarinë ka më tepër harxhime , si dhe koha që e kalon me fëmijët e mitur është më e lartë se sa koha që kalon prindi tjetër të cilit nuk i është dhënë kujdestaria ,pra me këtë automatikisht bëhet diskriminim dhe në praktikë rezultojnë shumë mangësi të cilat dalin pikërisht nga dhënia e kujdestarisë njërit prind dhe prindit tjetër i caktojnë kontakte direkte të cilat mund të jenë shumë të pakta dhe nuk i përgjigjen aspak interesit më të lartë të fëmijës, si dhe një alimentacion qesharak që e përmendëm pak më lartë.

## 2.1 Roli i Qendrës për Punë Sociale

Qendra për Punë Sociale luan rol tepër të rëndësishëm edhe në kontestet martesore që kanë të bëjnë me :

- **Shkurorëzimin e martesës** (seancë pajtuese)
- **Kujdestarinë e fëmijëve të mitur** (jep raport dhe mendim)
- **Ushtrimin e të drejtës prindërore** (këshillime)
- **Mbikëqyrjen e ushtrimit të së drejtës prindërore** (ndermarja e masave-interesi me i lartë i fëmijës)

Qendra për Punë Sociale ndihmon në zgjidhjen e problemeve midis bashkëshortëve dhe marrëdhënieve midis tyre, marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve ,si dhe në ushtimin e të drejtës prindore. Qendra si organ i kujdestarisë jep mbrojtje dhe ndihmë në konsultime dhe këshillime përmes një ekipi profesional të cilët merren me çështjet familjare .

Nga ky ekip i kualifikuar pritet që të tentojnë që ti pajtojnë bashkëshortët në procedurën për pajtim , mirëpo në të shumtën e rasteve këto përpjekje janë të parealizueshme dhe rezultojnë të pasuksesshme sepse bashkëshortët marrëdhëniet e të cilëve janë deri në atë masë të prishura nuk mund të rregullohen vetëm në një seancë pajtimi. <sup>28</sup>

Në procedurën për shkurorëzim të martesës dhe zbatimin e seancës për pajtim gjykata në afat prej 8 ditësh dërgon njoftim me shkrim deri te QPS për nevojën e zbatimit të seancës pajtuese dhe dhënien e mendimit për besimin e fëmijëve në ruajtje ,përkujdesje dhe edukim.QPS pasi ta merr njoftimin e regjistron lëndën dhe pas saj drejtori i QPS ia jep lëndën bashkëpunëtorit profesional përgjegjës i cili do të jetë si udhëheqës ose koordinator i asaj lënde i cili do të udhëheq ekipin profesional të përbërë nga jurist,pedagog,psikolog dhe sociolog . Bashkëpunëtori profesional i cili është udhëheqësi i ekipit ndërmerr disa veprime edhe atë:Hap dosje për lëndën dhe cakton afatin e veprimit duke marrë parasysh nivelin e rrezikut, cakton mbledhje me anëtarët e ekipit për tu njohur me problemin,

<sup>28</sup> <http://mtsp.gov.mk/content/pdf/standardi%20%20FINAL.pdf> publikuar më v.2014

cakton mbledhjen e parë me partnerët prindërit e fëmijëve në afat prej 5 ditësh pasi i është deleguar lënda, mirëpo në raste tek të cilat rrezikohet siguria e fëmijës veprohet në kohë të shkurtër dhe urgjente brenda 24 orëve. Në këtë mbledhje patjetër duhet që merr pjesë juristi me qëllim që tua sqarojë aspektet ligjore të procedurës, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e interesave dhe të drejtave të fëmijëve të mitur. Ekipi profesional bën një vlerësim në bazë të metodave dhe teknikave të cilat i kanë mësuar nëpër seminare dhe trajnime përkatëse, vlerësimin e kryejnë në hapësirat e QPS, ose në qoftë se është e nevojshme shkojnë edhe në këqyrje në shtëpinë e prindërve. Nga informacionet të cilat i kanë fituar në këtë fazë vlerësohet, shkalla e urgjencës me qëllim të ndërmarrjes së veprimeve urgjente dhe masave të nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve dhe familjes, shkallën e marrëdhënieve të prishura të bashkëshortëve, marrëdhëniet ndërmjet prindërve, statusin e fëmijës, marrëdhënien midis fëmijës dhe prindërve, aftësinë e prindërve për ruajtje dhe edukim të fëmijëve. Informacionet e marra shtesë i vendosin në listat të cilat i kanë hapur për lëndën konkrete dhe të njejtat pas secilit veprim të dhënat i vendosin në programin elektronik LIRIKUS, të gjitha aktivitetet e ndërmarra i vendosin në procesverbalin që e përpilojnë, gjithashtu edhe aktivitetet e ndërmarra nga takimi me prindërit dhe fëmijët, këqyrja në shtëpinë e prindërve etj, dhe pas kësaj përgatitet dhe jepet mendim nga ana e bashkëpunëtorit profesional. Në bazë të procedurës për udhëheqje me lëndën përpilohet një plan me aktivitetet e ndërmarra ndërmjet ekipit profesional, prindërve dhe fëmijëve, në suaza të QPS dhe jashtë saj. Jepet mendim për dhënie në ruajtje dhe besim të fëmijëve të mitur, dhe në qoftë se është e nevojshme ndërmerren masa për mbrojtje të fëmijëve të mitur me institutin e mbikëqyrjes gjatë ushtrimit të të drejtës prindërore.<sup>29</sup>

Mirëpo në praktikë nuk funksionon sipas standardeve të përmendura dhe në të shumtët e rasteve këto procedura zgjasin shumë dhe nuk veprohet në mënyrë urgjente duke i patur si prioritet këto raste të lartëpërmendura sepse QPS është e ngarkuar edhe me kompetenca tjera që kanë të bëjnë me adoptimin e fëmijëve, organin e kujdestarisë, dhunën në familje gjithashtu edhe shumë lëndë të tjera të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale, dhe duke

<sup>29</sup> <http://mtsp.gov.mk/content/pdf/standardi%20%20FINAL.pdf> publikuar më v.2014

patur parasysh se janë të stërngarkuar me shumë lëndë për të cilat është kompetente , duke mos patur staf dhe punonjës të mjaftueshëm profesional , nuk u kushtohet rëndësia e duhur secilit rast konkret pikërisht që kanë të bëjnë me kontestet martesore, këshillimin e prindërve, mendimin për ruajtje dhe besim të fëmijëve si dhe caktimin e dinamikës për mbajtje të kontakteve direkte dhe marrëdhënieve midis prindit të cilit nuk i jepet kujdestaria dhe fëmijës , por këto i bëjnë duke përdorur shabllone dhe duke vendosur për secilin rast pothuajse njëjtë me aryetime të ngjashme dhe vetëm për disa raste mund të vendosin ndryshe.

### **2.1.2 .Mendimi i Qendrës për Punë Sociale**

Qendra për Punë Sociale jep mendim dhe përgatit një raport se cilit nga prindërit do i jepen në ruajtje ,besim dhe edukim fëmijët e mitur, a do u jepen të gjithë fëmijët njërit prind ose do bëhet ndarja disa te nëna , disa te babai dhe prindit tjetër do t'i caktojë mbajtjen e kontakteve direkte me fëmijën në bazë të dinamikës që do e vendosë ekipi profesional.

Ekipi profesional në përbërje prej:juristit,psikologut,pedagogut dhe sociologut në bazë të procedurës të përmendur më lartë japin mendim secili prej tyre se cilit prej prindërve do i jepen në kujdestari fëmijët ,duke marrë parasysh takimet e realizuara ndërmjet prindërve,fëmijëve , duke e vlerësuar raportin dhe marrëdhënien e tyre , në qoftë se nuk arrijnë që prindërit sëbashku të merren vesh se kush do i mbajë në përkujdesje fëmijet dhe si do zhvillohen kontaktet me prindin tjetër atëherë vendos QPS , dhe duke i marrë parasysh aktivitetet e bëra sipas planit që kanë bërë ,duke vepruar sipas metodave dhe teknikave të punës , duke marrë parasysh gjendjen ekonomike të secilit prind, kushtet për jetesë të cilat mund ti'a ofrojnë fëmijës , pra duke marrë parasysh “interesin më të lartë të fëmijës”,moshën e fëmijës nqs është mbi 10 vj marrin edhe mendimin e fëmijës se me cilin nga prindërit dëshiron të jetojë(mirëpo në këtë rast fëmija ndihet në pozitë të vështirë dhe nuk di si të veprojë cilin prind ta zgjedh, sepse ata ndikohen edhe nga ana materiale dhe lehtë mund të manipulohen dhe ta ndryshojnë mendimin thjesht duke i premtuar njëri nga prindërit se do ti blejë lojëra të shtrenjta,do e dërgojë në ndonjë pushim në vendet ku dëshiron fëmija ,duke bërë çdo përpjekje për të marrë vëmendjen dhe dashurinë e fëmijës), duke patur parasysh këto rrethana ekipi profesional japin mendim se cilit prej prindërve do i jepet kujdestaria e fëmijës dhe mendimin e arsyetojnë me argumente se pse mendojnë ashtu, mendimin e përgatitur dhe raportin ia dërgojnë gjykatës kompetente tek e cila zhvillohet procedura për shkurorëzim të martesës .

Zakonisht në praktikë gjykata vendos sipas mendimit të dhënë nga QPS , mirëpo ndonjëherë ai mendim nuk është sjellur sipas standardeve që duhet të veprojë QPS ,pra ka mangësi dhe është sjellë duke pasur parasysh interesat e palëve të cilët kanë më tepër pushtet dhe autoritet dhe jo në bazë të interesit më të lartë të fëmijës.

Qendra për Punë Sociale gjatë sjelljes së mendimit duhet të ketë parasysh dhe duhet të respektojë interesin më të lartë të fëmijës dhe jo interesin dhe pretendimet që kanë ish-bashkëshortët në luftën që bëjnë për të fituar kujdestarinë e fëmijës.

Sipas nenit 78 parag.2 të Ligjit për familje të RMV-së “Qps me kërkesë të njërit prej prindërve ose në bazë të detyrës zyrtare do të sjell aktvendim për dhënie në besim , ruajtje dhe edukim të fëmijës në qoftë se këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara”

### **2.1.3 Vendosja e kontakteve personale midis fëmijës dhe prindit të cilit nuk i takon kujdestaria**

Në qoftë se në afat prej dy muajsh prindërit nuk arrijnë të bëjnë marrëveshje për mënyrën e mbajtjes së kontakteve direkte me fëmijën ,atëheqë QPS sjell aktvendim. Në momentin e vendosjes së kontakteve personale midis fëmijës dhe prindit të cilit nuk i takon kujdestaria QPS e informon fëmijën dhe i merr parasysh mendimet e tij në bazë të moshës së fëmijës ,shkallën e zhvillimit dhe e informon për pasojat e mundshme nga vendimet.

“Qendra për punë sociale me kërkesë të prindit mundet nga fillimi ta rregullojë mënyrën e mbajtjes së raporteve personale dhe kontakteve të drejtpërdrejta të prindërve me fëmijët nëse këtë e kërkojnë rrethanat e ndryshuara.

Mbajtja e raporteve personale dhe kontakteve të drejtpërdrejta të fëmijëve me prindërit mund të kufizohet ose përkohësisht të ndalohet vetëm për shkak të mbrojtjes së shëndetit dhe të interesave tjera të fëmijës.

Në rastin kur nuk realizohet e drejta e fëmijës së mitur që të mbajë kontakte të drejtpërdrejta me prindërit dhe familjarët tjerë të afërt të prindit i cili është i vdekur, të cilit i është marrë e drejta prindërore ose për arsye tjera është i penguar ta ushtrojë të drejtën prindërore, Qendra për Punë Sociale, sjell aktvendim për mënyrën e mbajtjes së kontakteve të drejtpërdrejta.”<sup>30</sup>

Përveq Ligjit familjar të RMV-së që e parasheh se prindi të cilin nuk i është dhënë kujdestaria ka të drejtë të mbajë kontakte dhe marrëdhënie të rregullta me fëmijët e mitur , kjo e drejtë gjithashtu është e rregulluar edhe në nenin 9 të Konventën për të drejtat e fëmijëve të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 20 nëntor 1989. Pra kjo e drejtë përjashtohet vetëm kur nuk është në interesin më të lartë të fëmijës edhe atë në qoftë se dëshmohet se prindi tjetër rrezikon mirëqënien ,integritetin dhe formimin e personalitetin e fëmijës, mirëpo në të kundërtën asesi kjo e drejtë nuk duhet të kufizohet dhe duhet të zbatohet ashtu sikurse është edhe e garantuar me ligjin familjar si dhe me konventën për të drejtat e fëmijëve.

<sup>30</sup> Neni 79 i Ligjit për familje të RMV-së

Në legjislacionin familjar të RMV-së nuk është e rregulluar detajisht mënyra e zhvillimit të kontakteve personale midis njerit prind dhe fëmijëve kur prinderit nuk jetojnë sëbashku. Vendimi për kontaktet është e drejtë diskrecionale e QPS e cila në praktikë rezulton me mjaft konflikte.<sup>31</sup>

Qendra për punë sociale sjell aktvendim me të cilën rregullon dinamikën dhe mënyrën e mbajtjes të kontakteve midis prindit të cilit nuk i jepet kujdestaria dhe fëmijës, duke marrë parasysh moshën e fëmijës, „interesin më të lartë“, lidhjen emocionale të fëmijës me prindin tjetër në bazë të planit, standardeve dhe metodologjisë të cilën e kemi përshkruar më lartë. Kundër këtij aktvendimi në afat prej 15 ditësh është e lejuar ankesa deri tek Ministria për Punë dhe Politikë Sociale e cila bën mbikëqyrjen e punës së Qendrës për Punë Sociale dhe pas këqyrjes së lëndës sjell aktvendim për pranimin ose refuzimin e ankesës, mirëpo kjo ankesë nuk e shtyn përmbarimin e aktvendimit të sjellë nga QPS, pas shfytëzimit të këtij mjeti juridik pala ka të drejtë të iniciojë kontest administrativ në gjykatën administrative.

Në praktikë vendimet të cilat i sjellë QPS për mënyrën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijën në të shumtën e rasteve nuk janë objektive sepse Qps vepron jo sipas interesit më të lartë të fëmijës por vendos në mënyrë subjektive në bazë të interesave të prindit tjetër i cili e ka edhe kujdestarinë e fëmijës dhe kjo gjë pikërisht e diskriminon prindin tjetër dhe e dëmton fëmijën sepse me këtë mënyrë nuk mund të realizojë të drejtën e tij të garantuar me ligj dhe me Konventën për të drejtat e fëmijëve që të ketë marrëdhënie me prindin tjetër dhe kontakte direkte edhe pse sjetojnë sëbashku të mund ta ndjejë përsëri dashurinë dhe kujdesin e prindit tjetër. Kjo e drejtë në praktikë zhvillohet me shumë pengesa për arsye se prindi i cili e ka kujdestarinë e fëmijës nuk lejon prindin tjetër që ta takojë fëmijën e pengon realizimin e kontakteve direkte midis fëmijës dhe prindit tjetër, nuk e respekton aktvendimin e sjellur nga ana e QPS, ndikon tek fëmija duke ia interpretuar situatën në mënyrën si don ai prind duke i folur keq për prindin tjetër duke i përdorur të gjitha „armët“ për ta drejtuar fëmijën kundër

<sup>31</sup> Лилјана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ и Ангел Ристов (2013), Семејно Право, Скопје, Блесок, стр. 201



prindit tjetër, sepse duke patur parasysh moshën e fëmijës dhe në qoftë se çdo ditë ushqehet me të njejtën gjuhë të urrejtjes dihet që ai fëmijë do të ndikohet nga fjalët që ia thot prindi me të cilin kalon pjesën më të madhe të kohës dhe do të mendojë se vetëm ai prind ia thotë të vërtetën se prindi tjetër i cili nuk e ka kujdestarinë nuk e do dhe nuk dëshiron të kujdeset për fëmijën ,pra gjitha këto janë një propagandë e prindit i cili e ka fituar kujdestarinë dhe përsëri e vazhdon luftën me ish partnerin duke u hakmarrë nëpërmjet fëmijës dhe duke mos e lejuar të realizojë të drejtën për të mbajtur kontakte me fëmijën , mirëpo në këtë mënyrë ata së pari e viktimizojnë fëmijën e tyre duke i lënë pasoja gjatë gjithë jetës si dhe së dyti edhe ish partnerin .

Avokati i popullit ka përpiluar një raport të veçantë për gjendjen e të drejtës të fëmijëve për mbajtjen e kontakteve me prindin me të cilin nuk jeton periudha 2014-2016 edhe atë e ka bërë për arsye se i janë dërguar shumë ankesa nga prindër dhe fëmijë pikërisht për mosrespektimin e kësaj të drejte dhe vendosjen subjektive nga ana e institucioneve përkatëse dhe pengimi nga ana e ish bashkëshortit për të realizuar kontaktet me fëmijën ,nga ky hulumtim u konstatua se shumë rrallë merren masa kundrejt prindin i cili e pengon mbajtjen e kontakteve midis prindit tjetër dhe fëmijës, dhe se përveq se nuk është e mjaftueshme vetëm ti udhëzojnë që të ndjekin një këshillimore përkatëse por për këtë duhet të merren masa dhe të sanksionohet një sjellje e tillë dhe të bëhet mbikqyrje nga ana e QPS derisa të jetë e nevojshme për hir të interesit më të lartë të fëmijës<sup>32</sup>

<sup>32</sup> <http://ombudsman.mk/upload/Posebni%20izvestaj/2017/Poseben%20izvestaj-Licni%20kontakti-2017.pdf>  
publikuar më Dhjetor,2017

## **2.2. Analizë e rastit konkret për shkurorëzimin e martesës dhe kujdestarinë e fëmijës së mitur në Republikën e Maqedonisë së Veriut**

Bëhet fjalë për lëndën nr:P2-31/17 të zhvilluar në Gjykatën Themelore të Manastirit ku do të shohim qartë si është zhvilluar procedura ,si kanë vepruar institucionet përkatëse me theks të veçantë Qendra për Punë sociale,dhe vendimin përfundimtar të sjellur nga Gjykata themelore e Manastirit , ku procedura në fjalë ka zgjatur gati 3 vjet e cila nuk është e zakonshme për një procedurë shkurorëzimi të zgjasë aq shumë sa në rastin konkret . Bëhet fjalë për GJ.E e cila është shtetase e Republikës së Shqipërisë dhe S.O i cili është shtetas i RMV-së të cilët kanë lidhur kurorë në datë 21.09.2014 kurse në datë: 13.12.2015 në jetë ka ardhur fëmija e tyre S.M dhe pikërisht pas kësaj periudhe kanë filluar edhe problemet mes GJ.E , S.O-së dhe familjes së tij , për arsye se qëllimi i tyre ka qenë të marrin një nuse nga Shqipëria vetëm për të lindur një fëmijë dhe më pas fëmijën ta mbajnë dhe nusen ta përzënë përsëri për në Shqipëri GJ.E , e kanë trajtuar shumë keq duke e nënvlerësuar, duke i thënë fjalë të ndryshme nënçmuese duke përdorur fjalë kundër nacionalitetit të GJ.E etj . Pra gjithë kohës pas lindjes së vajzës ata janë sjellur shumë keq me GJ.E dhe grindja më e madhe ka ardhur për arsye se GJ.E ka kërkuar që të shkojë për vizitë tek prindërit e saj në Shqipëri së bashku me vajzën dhe në një moment për arsye se vjerra e saj në mënyrë agresive ia ka marrë fëmijën kur pikërisht nga ky rast GJ.E ka përfunduar në Spital duke pirë një sasi prej 8-të tabletave qetësuese me të cilin gjest ka dashur të kërkojë ndihmë për arsye se askush se ka kuptuar dhe se ka ndihmuar. Pikërisht këtë situatë e ka shfytëzuar vjehëri i GJ.E i cili ia ka çlajmëruar vendqëndrimin GJ.E nga shtëpia e tyre duke u thënë se ajo nuk jeton më aty.

GJ.E është dashur të qëndrojë rreth 12 ditë në Spital në Manastir ku për asnjë ditë gjatë qëndrimit nuk kanë shkuar për ta vizituar familja e S.O dhe nuk ia kanë dërguar vajzën për ta parë , pra pikërisht edhe ky ka qenë skenari që e kanë përgatitur S.O dhe familja e tij për të marrë një grua nga Shqipëria tju bëjë një fëmijë dhe ta kenë më të lehtë për ta përzënë dhe për të marrë fëmijën “për arsye se meqë janë shtetas të RMV-së kanë më shumë të drejta nëpër institucione” .

Pas daljes nga spitali janë takuar të dyja familjet dhe janë marrë vesh që GJ.E të shkojë tek prindërit e saj për të qëndruar 10 ditë për të pushuar dhe pas saj të kthehet në Manastir me qëllim që të vendos se a dëshiron të vazhdojë martesën e saj me S.O dhe për këtë menjëherë janë informuar edhe punëtorët social të QPS –Manastir të cilët e kanë përkrahur këtë mënyrë të veprimit.

Pas kësaj GJ.E largohet për në Shqipëri duke e informuar edhe QPS për ditën e nisjes dhe të kthimit. Ditën që kthehet për arsye të mbarimit të lejes për vendqëndrim lajmërohet në organet e MPB-së për vazhdim të vendqëndrimit dhe pikërisht atje mëson se vjerri I saj e ka çlajmëruar "për arsye se ajo e ka braktisur vajzën e mitur". Pas kësaj GJ.E I drejtohet QPS dhe jep deklaratë se jeta martesore nuk ka më kushte për tu vazhduar së bashku dhe kërkon që vajza e mitur t'i jepet asaj në kujdestari .

GJ.E vendos që të qëndrojë në Manastir dhe për të luftuar për të drejtën që të merr vajzën e saj në kujdestari për arsye se ishte tepër e vogël dhe I duhej kujdesi I nënës , aplikon për vazhdimin e vendqëndrimit duke lidhur Kontatë për Qira në Manastir me qëllim që të jetë sa më afër vajzës së saj dhe bën kërkesë në QPS që ta merr kujdestarinë e vajzës , mirëpo kërkesë të njejtë kishte bërë edhe S.O i cili u kishte bashkangjitur "dëshmi se GJ.E vuan me skizofreni me shifër F70" ku pas kësaj menjëherë nga ana e avokatit dhe GJ.E është bërë kërkesë për të bërë një ekspertizë e cila është përgatitur nga eksperti L.A neuropsikijatër në Manastir e cila është dërguar në QPS më datë 19.12.2016 me propozim që të merret historiat mjekësor i S.O për arsye se dyshonin se bëhet fjalë për person me Epilepsi.

Pas kësaj më datë 17.02.2017 QPS –Manastir sjell akvendim me nr: 0803-131/16 me të cilën ia refuzon kërkesën GJ.E për dhënien e Kujdestarisë së vajzës së mitur deri në përfundimin e procedurës gjyqësore , kurse S.Ot ia miratoi kërkesën dhe ia besoi kujdestarinë e vajzës për ruajtje, kujdes,edukim , dhe S.M në fakt në këtë rast ishte në kujdestari të gjyshit dhe gjyshes dhe jo në kujdestari të prindit(babait) sepse ata kujdeseshin për S.M e vogël dhe jo ai , kundër këtij vendimi u inicua kontest administrativ.

Menjëherë pas kësaj më date:09.03.2017 filloi procedura gjyqësore për shkurorëzim të martesës dhe dhënien në besim , ruajtje dhe kujdes të fëmijës së mitur ku të dy prindërit kërkuan që ta kenë kujdestarinë e fëmijës.

Ndërkohë janë pyetur edhe përfaqësues të QPS-Manastir të cilët dhanë mendim se vajza duhet ti jepet S.Ot me arsyetim se kinse GJ.E rregullisht konsumon tableta dhe ka probleme tjera shëndetësore. Nuk kanë mohuar se është komunikuar me ta nga ana e GJ.E gjatë gjithë kohës. Gjithashtu si dëshmitarë janë dëgjuar edhe prindërit e S.O të cilët kanë dhënë deklarata skandaloze për GJ.E ,për shqiptarët ,sjelljen etj.

Në bazë të asaj se kishte kaluar një periudhë më e gjatë është kërkuar një ekspertizë tjetër për GJ.E me qëllim që QPS të sjell mendim të ri .Eksperti më datë 26.02.2018 dha një mendim të ri me konkluzione se gjithçka është në rregull me GJ.E se asnjëherë nuk ka patur diagnozë F70 siç kanë deklaruar S.O dhe familja e tij në fillim,GJ.E kur ka qenë më e vogël e ka humbur dëgjimin mirëpo me intervenim dhe me vendosjen e aparatit për dëgjim këtë funksion e kryen pa asnjë problem dhe probleme të tjera shëndetësore nuk ka.

Në shqyrtimin kryesor të mbajtur më date:13.06.2018 është pyetur edhe mjeku amë i S.Ot S.J i cili e solli të gjithë historiatin medicinal të S.Ot edhe atë prej raporteve të dhëna nga neurolog C... Dhe T .. S.O është diagnostikuar me Epilepsi.

Ky dokumentacion më datë 14.06.2018 dhe më datë 02.07.2018 i është dërguar QPS me kërkesë që ta kenë parasysh për mendimin tjetër që do e sjellin për vajzën e mitur S.M.

Më datë 02.07.2018 QPS e informon avokatin e GJ.E se veçmë është dërguar mendimi deri tek gjykata dhe ekipi profesional përsëri japin mendimin e njejtë që S.M të rrijë në kujdestari të S.Ot pra të babait deri në pëfundimin e procedurës së shkurorëzimit me arsyetim se S.O mund të kujdeset për S.M me ndihmën e prindërve të tij dmth me ndihmën e nënës dhe kurse fëmija është lidhur emocionalisht më shumë me babain (duke patur parasysh që fëmija 11 muajsh të jetë e lidhur më tepër emocionalisht me babain është pak absurde )domethënë QPS nuk e kanë marrë parasysh ekspertizën e bërë dhe rrethanat e ndryshuara dhe duke vendosur përsëri në mënyrë subjektive dhe jo në bazë të interesit më të lartë të fëmijës.

Më datë 04.09.2018 Avokati i GJ.E ka dërguar një parashkresë se nuk dakordohen me mendimin e njëjtë të dhënë nga ana e QPS-Manastir dhe se për të njëjtën do ta njoftojë Ministrinë për Punë dhe Politikë Sociale.

Në seancën e radhës gjykata në bazë të propozimit të bërë nga ana e GJ.E dhe Avokatit të saj solli vendim që të bëhet edhe një ekspertizë e re për S.O si dhe QPS të sjell vendim të ri në bazë të rrethanave të ndryshuara.

Menjëherë pas kësaj më datë 15.09.2018 Avokati e ka njoftuar me shkresë Ministren Caroska për të gjithë situatën dhe veprimet e QPS Manastir dhe në të njëjtën kohë me kërkesë i është drejtuar edhe QPS-Manastir ku ka kërkuar që përpara se të sillet mendimi i ri nga ana e këtij institucioni sipas aktvendimit të gjykatës , ekipi profesional i cili ka dhënë mendime dhe ka vendosur për lëndën të PËRJASHTOHET për arsye se gjatë gjithë kohës kanë qenë joobjektiv.

Më datë 19.10.2018 nga ana e Ministrisë për Punë dhe Politikë Sociale është sjellur njoftim me nr: 10-9816/4 ku në bazë të kërkesës së palës Enti për Veprimtari Sociale Shkup ka bërë mbikqyrje rreth punës së Ekipit profesional në QPS -Manastir për rastin konkret dhe janë konstatuar shkelje serioze dhe mangësi gjatë dhënies së mendimit për besimin e fëmijës tek babai i saj edhe atë në bazë të raportit të dhënë nga kjo mbikëqyrje është konstatuar se:

1. Rekomandimet dhe mendimet e punëtorëve social, pjesërisht pasqyrojnë profilin e punëtorit profesional që e ka hartuar atë dhe nuk përmban argumente të mjaftueshme në bazë të cilave është ngritur mendimi i ekipit profesional.
2. Gjatë vlerësimit të shfrytëzuesve nga ana e Ekipit profesional nuk janë zbatuar teknikat , dhe mësimet që janë marrë në bazë të Trajnimit për zhvillim profesional .
3. Mungon mendim i dhënë i JURISTIT(mendim i cili është mjaft i rëndësishëm)
4. Planet për punë individuale me shfrytëzuesit nuk janë të kuptueshme dhe nuk ka patur participim të shfrytëzuesve.
5. Lënda nuk është evidentuar në programin elektronik LIRIKUS

Pas shqyrtimit të mangësive Enti për Veprimtari Sociale -Shkup ka dhënë disa rekomandime edhe atë:

1. Në vendosjen e mëtejshme të lëndës , të merret parasysh INTERESI MË I LARTË I FËMIJËS,
2. QPS para marrjes së mendimit të ri të bëjë rivlerësim për nevojat e fëmijës dhe kapacitetin e prindërve në bazë të teknikave për vlerësim ,të merret parasysh edhe dokumentacioni medicinal për gjendjen shëndetësore të prindërve dhe informacionet e marra të shërbejnë për dhënien e mendimit profesional në bazë të dokumenteve profesionale.
3. Ekipi profesional të veprojë në bazë të Standardeve dhe procedurave për veprim të Qendrave për Punë Sociale në RM
4. Plani për punë Individuale të bëhet me detyra konkrete për secilin punëtor profesional , me aktivitete konkrete dhe dinamike të duhur në bazë të afatit të dhënë
5. Lënda të evidentohet në programin elektronik të të dhënave LIRIKUS dhe në kontinuitet të përditësohet.

Për të gjitha aktivitetet që do të ndërmerren në bazë të udhëzimeve të dhëna duhet që të informohet Enti për veprimtari sociale-Shkup,duke dorëzuar Njoftim dhe kopje të dokumentacionit profesional.<sup>33</sup>

Ndërkohë nga ana e ekspertit Dr. L.A është sjellur ekspertizë e re për S.O. ku është konstatuar gjendja e tij shëndetësore EPILEPSI dhe karakteristika të tjera.

Më datë 14.11.2018 është mbajtur seancë gjyqësore e radhës në të cilën janë dëgjuar përfaqësuesit e QPS-Manastir dhe palët , në të cilën Avokati i GJ.E ka kërkuar që të pyetet eksperti L.A në rrethana të ekspertizës, si dhe duke patur parasysh se ende nuk është vendosur

<sup>33</sup> Raport për mbikqyrje të punës së ekipit profesional të QPS-Manastir-Lënda S.M.S,Shkup,Tetor,v.2018

sipas propozimit për Përrjashtim të ekipit profesional konkret të mos pyeten përfaqësuesit e QPS aktual.

Përfaqësuesi i QPS-Manastir SH.G në cilësi të anëtarit të ekipit profesional tha se kanë dhënë mendim të ri të tretë i cili nuk ndryshon nga mendimet paraprake dhe se propozojnë që S.M të mbetet tek babai i saj. Në pyetjen e parashtruar nga ana e Avokatit se a është bërë kërkesë për përjashtim të ekipit profesional dhe a është vepruar sipas saj , punëtori social është përgjigjur se ka patur kërkesë për përjashtim të Ekipit profesional dhe se ende nuk është vendosur sipas të njëjtës, dhe se ai ende vazhdon të jetë pjesë e ekipit me urdhër gojor të dhënë nga udhëheqësi i QPS-Manastir që ekipi i njëjtë të vazhdojë të veprojë për këtë lëndë. Si dhe ka deklaruar se nuk kanë vepruar sipas rekomandimeve të dhëna nga ana e Entit për veprimtari sociale.

Gjykatësi i cili e ka gjykuar lëndën së bashku me këshillin gjyqësor të gjitha propozimet e bëra nga ana e GJ.E i ka refuzuar , dhe në mënyrë indirekte e ka legjitimuar veprimin joligjor të ekipit profesional për rastin konkret për arsye se në bazë të nenit 27 të Ligjit për Procedurë të Përgjithshme Administrative, në rast se ka propozim për përjashtim të personit zyrtar ose i gjithë organit kolegial , të gjitha veprimet zyrtare të ndërmara pas saj janë KUNDËRLIGJORE!

Kjo paraqet edhe njëherë dëshmi se ky ekip me çdo kusht insistojnë që S.M edhe pse në moshë të vogël vetëm 11 muajshe ti jepet në besim,ruajtje dhe përkujdesje babait të saj i cili ka probleme shëndetësore , dhe kjo bëhet me ndihmë të institucioneve shtetërore të cilët në vend që të veprojnë në mënyrë objektive dhe të veprojnë sipas ligjit ata përkundër kësaj veprojnë në mënyrë subjektive duke e mbështetur S.O i cili është shtetas i RMV-së dhe e zvarrisin GJ.E e cila është shtetase e Shqipërisë e cila mundohet të qëndrojë në RMV vetëm për të qenë sa më afër vajzës së saj, duke patur parasysh se nuk ka ndihmë nga askush sepse edhe institucionet e diskriminojnë në këtë mënyrë.

QPS –Manastir me aktvendim ka rregulluar mënyrën dhe dinamikën e mbajtjes së kontakteve për vajzën e mitur me kërkesë të nënës së saj GJ.E ku si fillim i kanë lejuar të takohet me vajzën e mitur në ambientet të QPS nën mbikëqyrje të ekipit ( e cila është mjaft e ulët dhe e ndijshme të zhvillosh kontakte me vajzën e mitur nën ambientet e QPS ) edhe atë vetëm dy orë çdo dy

javë, më pas me kërkesë të GJ.E takimet janë përshpejtuar në njëherë në javë çdo të dielë prej orës 11 deri në ora 13 në shtëpinë e GJ.E edhe atë në prani të të dy prindërve , përsëri koha e kaluar midis GJ.E dhe vajzës së mitur ka qenë mjaft e kufizuar dhe në atë mënyrë nuk është vepruar aspak sipas interesit më të lartë të fëmijës, në bazë të shumë përpjekjeve dhe kërkesave për ndryshim të aktvendimeve dhe për rritje të dinamikës dhe mënyrës për zhvillim të kontakteve me shumë mund kanë arritur të shpreshtohen në caktim të kontakteve në më shumë ditë edhe atë duke filluar në fund edhe gjatë natës. Në verë të vitit 2018 fëmija ka kaluar më shumë ditë tek nëna dhe në zhvillimin e saj nuk ka patur asnjë problem por përkundrazi ka ndikuar shumë edhe tek S.M edhe tek GJ.E duke shfaqur kështu më tepër gëzim dhe lumturi .

Si përfundim Gjykata Themelore Manastir në vendimin përfundimtar të sjellur me aktgjykimin për shkurorëzim të martesës , e shkurorëzoi martesën dhe fëmijën e mitur S.M e cila në kohën kur mbaroi procedura gjyqësore arriti moshën 3 vjeçare, ia besoi në ruajtje, edukim dhe në mbajtje të pjesërishtme nënës GJ.E , duke vepruar kështu kundër vendimit të sjellur nga ana e QPS Manastir të cilët tre herë sollën vendimin e njëjtë që vajza e mitur të jetë në besim, ruajtje dhe edukim tek babai S.O dhe ky mund të jetë ndër raste të ralla që Gjykata të vendosë ndryshe nga mendimi i dhënë nga QPS duke respektuar kështu interesin më të lartë të fëmijës, si dhe Obligoi babain S.O që të paguajë alimentacion për vajzën e mitur edhe atë në shumë prej 3500 denarë çdo muaj nëpërmjet nënës së saj E.GJ.

Pas shkurorëzimit të martesës GJ.E qëndroi në Manastir bashkë me vajzën dhe duke ia mundësuar kështu S.Ot dhe familjes së tij mbajtjen e kontakteve të rregullta duke vepruar sipas aktvendimit të QPS , S.O mbante kontakte të rregullta me vajzën edhe atë çdo dy javë për vikend me fletje e premtje ,e shtunë e diel.

Për arsye se prindërit e GJ.E kishin tepër shpenzime për të udhëtuar shpesh nga Shqipëria për në Manastir për ti ndihmuar vajzës së tyre GJ.E në kujdesin me fëmijën e saj ,ata vendosën që GJ.E të vazhdojë lejen e Qëndrimit në RMV edhe atë duke lidhur kontratë për qira në Strugë për arsye se e kishin më afër dhe nuk kishte asnjë problem për ti ndihmuar vajzës së tyre GJ.E dhe kështu iu vazhdua vendqëndrimi për 1 vjet dhe kompetente për të dhënë vendim për



mënyrën e realizimit të kontakteve mes vajzës së mitur dhe S.O ,e cila filloi të jetojë në Strugë së bashku me nënën e saj gjyshin dhe gjyshen, kompetente u bë QPS Strugë dhe ajo solli aktvendim që kontaktet me vajzën do të vazhdojnë njëjtë siç kanë qenë çdo dy javë me fjetje mirëpo S.O ishte i obliguar që të vjen në Strugë ta merr vajzën para shtëpisë së GJ.E dhe ta kthejë përsëri sipas aktvendimit të sjellur nga QPS Strugë . Takimet zhvilloheshin në mënyrë të rregulltë dhe pa ndërprerje .

GJ.E ishte mjaft e kënaqur për arsye se në QPS Strugë e kishin pritur me më tepër mirësjellje dhe e kishin respektuar gjë të cilën në QPS Manastir si dhe në institucionet tjera atje nuk e ka përjetuar asnjëherë sepse çdo herë ka qenë e diskriminuar dhe e nënvlerësuar.

Këtë rast e kam ndjekur nga afër dhe kam parë që vajza është shumë më e lumtur , më e buzëqeshur dhe përplot energji që po jeton me nënën e saj. Kjo procedurë ka zgjatur mjaft mirëpo pas shumë përpjekjesh u befasuam shumë që Gjykata themelore në Manastir vendosi ndryshe nga Mendimi i QPS të cilët ishin subjektiv gjatë gjithë kohës dhe vendimi u soll më në fund duke vlerësuar interesin më të lartë të vajzës .

## 2.3 RASTI MITOVI KUNDËR RM-SË

Procedura filloi me ankesë nr.53565/13 kundër RM-së inicuar nga tre ankues Z.Marjan Mitov (ankuesi i parë),znj.Cveta Mitova(ankuesja e dytë) dhe z.Denco Mitov (ankuesi i tretë) deri tek Gjykata Evropiane për të drejtat e njeriut në Strasburg në Gusht të vitit 2013. Ankuesit e dytë dhe të tretë janë prindërit e ankuesit të parë.<sup>34</sup>

Ankuesit u ankuan në bazë të nenit 6, 8 dhe 13 të Konventës për arsye se kanë qenë të privuar nga e drejta për të mbajtur kontakte me M.M (vajzën e ankuesit të parë).

Ankuesi I pare jeton në Sidnej Australi kurse ankuesit tjerë jetojnë në Shkup. Në shtator të vitit 2008 ka lidhur kurorë me znj.J.S.M në Shkup, pas asaj periudhe kanë jetuar së bashku në Australi deri në vitin 2011 ku marrëdhëniet e tyre janë prishur dhe jeta martesore është bërë e padurueshme dhe janë kthyer në shtetin e paditur.Vajza e tyre M.M ka lindur në gusht të vitit 2010.<sup>35</sup>

Në 10 tetor të vitit 2011 znj.JSM ka inicuar padi për shkurorëzim të martesës me ankuesin e pare.Kurse më 6 dhejtor 2011 ankuesi i parë ku ka kërkuar nga QPS që t'i rregulluhoet mënyra për zhvillimin e kontakteve me fëmijën e mitur. Më 3 janar të v.2012 QPS ia beson në ruajtje dhe edukim vajzën M.M nënës JSM deri në përfundim të procedurës për shkurorëzim , kurse babait ankuesit të parë i ka caktuar të drejtën për të mbajtur kontakte me fëmijën edhe atë një orë dy herë në muaj në hapësirat e QPS edhe atë në mbikëqyrje të punonjësve social.Gjithashtu është obliguar JSM që ta çojë vajzën tek hapësirat e QPS për të mundësuar kontakte babai me vajzën e mitur.<sup>36</sup>

<sup>34</sup> Случај МИТОВИ против Република Македонија(жалба бр.53565/13) Пресуда Стразбур 16 април 2015

<sup>35</sup> По ату

<sup>36</sup> По ату

MPPS pas shqyrtimit të ankesës të inicuar nga ana e babait të fëmijës e ka anuluar aktvendimin e QPS dhe e ka urdhëruar QPS që të merr parasysh interesin më të lartë të fëmijës. Para kësaj date ankuesi i parë e ka parë fëmijën vetëm njëherë në 13 janar 2012.<sup>37</sup>

Në 16 maj 2012 gjykata themelore e ka shkurorëzuar martesën dhe vajzën e mitur ia ka dhënë në kujdestari nënës ,kurse ankuesin e parë e ka obliguar që të paguajë alimentacion për vajzën kurse e ka lejuar që të mbajë kontakte me vajzën në bazë të vendimit të QPS.

Ndërkohë më 10 maj 2012 ankuesi i parë ka bërë kërkesë të re tek QPS për mbajtjen e kontakteve me vajzën M.M. Dhe më 4 korrik QPS ka sjellur vendim që të mund të mbajë kontakte me vajzën 4 herë në muaj, mirëpo përsëri JSM nuk e ka respektuar vendimin e QPS dhe ka penguar që ankuesi i parë të zhvillojë kontakte me vajzën duke mos ia çuar dhe duke mos e respektuar as vendimin e QPS por as edhe interesin më të mirë të vajzës.

Më 8 tetor 2012 ankuesi i parë e ka njoftuar QPS se kthehet ne Australi. Kurse më prill të 2013 e ka njoftuar QPS se do të ndodhet në shtetin e paditur në periudhën prej 16 maj deri më 2 shtator 2013 , dhe më 23 prill 2013 ka kërkuar nga QPS që ti'a rregullojë mënyrën e mbajtjes së kontakteve me vajzën e mitur.Në kuadër të kësaj QPS sjell aktvendim ku i lejon që babai të zhvillojë kontakte me vajzën edhe atë dy here në muaj në kohëzgjatje prej 8 orësh edhe atë pa mbikqyrje të QPS, gjithashtu e ka rregulluar edhe mënyrën e mbajtjes së kontakteve gjatë ditëve të punës dhe për ditëlindjen e vajzës. Ankuesi I parë e ka parë vajzën e tij vetëm njëherë shkurt edhe atë në hapësirat e QPS nën mbikëqyrje të personave zyrtarë.

Më 3 korrik të vitit 2013 ,ka dërguar kërkesë deri tek Ministria duke kërkuar asistim për përmbarimin e aktvendimit të QPS.

Më 8 korrik 2013 ankuesi i parë ka kërkuar nga QPS që të ndërmarrin veprim për përmbarimin e aktvendimit si dhe ka kërkuar në bazë të nenit 87 parag.4 dhe paragrafi.6 të Ligjit për familje të ketë kujdestari të përkohshme të fëmijës për arsye se znj.JSM nuk ka vepruar sipas aktvendimit të QPS dhe nuk e ka respektuar të drejtën e prindit tjetër dhe fëmijës që të realizojnë kontakte

<sup>37</sup> Po aty

me njëri tjetrin e cila është e drejtë themelore e garantuar me Konventë si dhe me Ligjin për familje të RM-së , duke marrë parasysh periudhën e gjatë prej dy vitesh nuk e ka pare fare vajzën e tij dhe ka kërkuar nga QPS përgjegjësi për përmbarimin e aktvendimit sepse sipas Ligjit për familje neni 87 parag 4 : “Qendra mund të sjell aktvendim me të cilin do ta jape fëmijën në qëndrim te prindi të cilit fëmija nuk i është besuar për ruajtje dhe edukim, për një periudhë të caktuar kohore, por jo më shumë se 15 ditë, nëse më shumë se dy herë radhazi prindi tjetër pa arsye nuk e ka respektuar vendimin e qendrës të punës sociale.”

Sipas Ligjit për familje neni 87 paragrafi 6 “Qendra e punës sociale do të marrë vendim me të cilin përkohësisht do t’ia besojë fëmijën prindit tjetër, personit të tretë ose do ta vendosë në familje tjetër ose në institucion përkatës, si zgjedhje e fundit, nëse ka njohuri se marrëdhëniet personale dhe kontaktet e drejtpërdrejta të fëmijës janë ndërprerë më shumë se dy muaj për shkak të mosveprimit sipas vendimit të qendrës së punës sociale të prindit të cilit fëmija i është besuar ose për shkak të marrëdhënieve të prishura të partnerëve, që shprehen dëmshëm në zhvillimin e fëmijës.”<sup>38</sup>

Ndërkohë edhe ankuesit e dytë pra gjyshi dhe gjyshja kanë bërë kërkesë deri tek QPS për të zhvilluar kontakte me vajzën e mitur ,ku është sjellur aktvendim ku u është caktuar mënyra e mbajtjes së kontakteve si dhe në vendim është potencuar se në çdo takim të rezervuar për ankuesin e dytë dhe të tretë me vajzën e mitur M.M nqs nuk realizohen atëherë do duhet të kompensohet.

Edhe pas këtij vendimi JSM nuk ka vepruar dhe nuk ua ka çuar vajzën për ta pare gjyshi me gjyshen ,kështu ka vepruar edhe me vendimet tjera, ku QPS gjatë gjithë procedurës ka sjellur gjithsej 7 aktvendime për të rregulluar mënyrën dhe dinamikën e zhvillimit të kontakteve mes babait dhe fëmijës së mitur si dhe mes gjyshit,gjyshes dhe vajzës së mitur .

Në arsyetimin e Aktgjykimit të Gjykatës Evropiane Për të Drejtat e Njeriut gjykata ka vërejtur se janë bërë shkelje të të drejtave të garantuara me Konventë edhe atë neni 8 dhe neni 13, është vërejtur se Qendra për punë sociale ka vepruar me vonesë gjatë sjelljes së vendimeve si dhe u është dashur prej 3 deri më 5 muaj për të vendosur edhe atë duke patur parasysh se ankuesi i parë e ka patur kohën e kufizuar për të ndejtur në shtetin paditës ,përkundër kësaj QPS nuk ka

<sup>38</sup> Ligji për familje i RMV-së

ndërrmarrë asnjë veprim për përmbarrimin e vendimeve që i ka sjellur dhe nuk ka vepruar për marrjen e masave konkrete që nëna JSM tu mundësojë babait të vajzës si dhe gjyshit me gjyshen mbajtjen e kontakteve e cila është e drejtë e garantuar.

Kundër JSM janë inicuar edhe procedura penale në bazë të nenit 198 të Kodit Penal të RM-së parag.1” Ai i cili në mënyrë të kundërligjshme do ta marrë personin e mitur nga prindi,birësuesi ,tutori,nga institucioni apo nga personi të cilit i është besuar ,apo pengon që ai të jetë te personi i cili ka të drejtë në të apo pamundëson zbatimin e vendimit të prerë për ndarjen e personit të mitur,do të dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vjet”,kurse në bazë të parag 3 të këtij ligji “ Gjatë shqiptimit të dënimit me kusht gjyqi mund t’i urdhërojë kryerësit ta kthejë personin e mitur apo të mundësojë zbatimin e vendimit të prerë për ndarjen e personit të mitur”<sup>39</sup>

J.S.M. është shpallur fajtores dhe është dënuar me burgim 3 muaj, shtyrë për 1 vjet deri në plotfuqishmërinë e aktgjykimit,edhe pas kësaj ajo përsëri ka penguar mbajtjen e kontakteve me vajzën e mitur me babain dhe gjyshërit e saj.

Institucionet nuk kanë ndërrmarrë asnjë masë për përmbarrimin e vendimeve të QPS që shihet qartë një mungesë të rregullimit ligjor pikërisht për çështjen e përmbarrimit të aktvendimeve të cilat i sjellë Qendra për Punë Sociale.<sup>40</sup>

<sup>39</sup> Osmani Afrim,Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë,Teksti integral,i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime,treguesi alfabetik,Shkup, Furkan ISM,2010

<sup>40</sup> Случај МИТОВИ против Република Македонија(жалба бр.53565/13) Пресуда Стразбур 16 април 2015

## **KAPITULLI I TRETË: PËRGJEGJËSIA PRINDËRORE**

### **3.Ushtrimi i të drejtës prindërore**

Përgjegjësia prindore është e barabartë si për nënën ashtu edhe për babain ,kjo përgjegjësi është e barabartë edhe kur partnerët janë në martesë dhe duhet të mbetet e njejtë edhe pas shkurorëzimit të martesës ,pra pa marrë parasysh se cilit prej prindërve i është dhënë në kujdestari fëmija ata duhet sëbashku të kujdesen për fëmijën t’ia plotësojnë të gjitha kushtet dhe nevojat kryesore për fëmijën si dhe së bashku të ushtrojnë përgjegjësinë prindore duke arritur të bëjnë marrëveshje për fëmijën , bashkarisht të vendosin se në cilën shkollë do ta çojnë fëmijën e tyre,në çfarë kursi do ta regjistrojnë , në cilin mjek do të vizitohet ose shërohet.

Në asnjë mënyrë prindi i cili e ka kujdestarinë e fëmijës nuk duhet që të ndalojë ose të pengojë prindin tjetër që të kujdeset për fëmijën të kontribuojë për të , si dhe nuk duhet të ndalojë mbajtjen e kontakteve midis prindit tjetër dhe fëmijës sepse fundja ai ose ajo është prindi tjetër dhe ka të njejtën përgjegjësi për fëmijën .

Prindi i cili e ka kujdestarinë e fëmijës duke respektuar interesin më të lartë të fëmijës duhet që ta lerë prindin tjetër të zhvillojë kontakte me fëmijën edhe pas ditëve që caktuar QPS me atvendim , për arsye se fëmija që të ketë një jetë të qetë dhe të lumtur duhet të kalojë kohë të mjaftueshme dhe të barabartë me të dy prindërit edhe atë duhet t’i mundësohet që tëshkojë në pushime edhe me prindin me të cilin nuk jeton si dhe të kalojë kohë më tepër edhe për fundjava.

Kufizimi i kohës për mbajtjen e kontakteve me fëmijën nuk e plotëson interesin më të lartë të fëmijës dhe në këtë mënyrë prindi tjetër i cili mund ta shikojë fëmijën e tij shumë rrallë nuk mund ta ushtrojë të drejtën dhe përgjegjësinë prindërore në mënyrë të barabartë siç mund ta ushtrojë prindi i cili e ka kujdestarinë.

Duke mos patur kontakte dhe marrëdhënie të rregullta është tepër e vështirë edhe për prindin tjetër që të ushtrojë të drejtën prindërore dhe të jetë i gatshëm për t’i ndihmuar fëmijës në çdo kohë që i nevojitet ,por është edhe tepër e vështirë për fëmijën e mitur sepse mund të ndihet

shumë i vetmuar duke mos patur mundësi që të rritet në mënyrë të barabartë nga të dy prindërit

### **3.1. Mbikëqyrje gjatë ushtrimit të së drejtës prindërore**

Qendra për punë Sociale bën mbikëqyrje gjatë ushtrimit të të drejtës prindërore sipas Ligjit për familje të RMV-së. QPS obligohet që t'i ndërmerr masat e nevojshme për shkak të mbrojtjes së personalitetit, të drejtave dhe interesit më të lartë të fëmijës. Për atë çdo qytetar, institucion ose person juridik është i obliguar që ta njoftojë QPS menjëherë sapo të jetë i informuar se prindi nuk e kryen të drejtën prindërore ose për arsye të tjera i janë të nevojshme fëmijës mbrojtja e personalitetit të drejtave dhe interesave të fëmijës.<sup>41</sup>

QPS ka rol aktiv sidomos kur janë në pyetje interesat e fëmijës edhe atë, i paralajmëron prindërit për mangësit në edukimin dhe zhvillimin e fëmijës, mund ti udhëzojë ata vetëm ose sëbashku me fëmijën të vizitojnë këshillimore përkatëse ose ndonjë institucion shëndetësor, social ose edukativ të cilët mund tu japin këshillat e duhura.

Në disa raste në qoftë se këtë e kërkojnë interesat e fëmijës, Qendra mund të sjellë aktvendim për mbikëqyrje të vazhdueshme gjatë ushtrimit të të drejtës prindërore për një fëmijë ose vetëm për njërin nga ata.

Ekzistojnë situata kur prindërit nuk i përmbushin siç duhet obligimet ligjore të përcaktuara të cilat i kanë ndaj fëmijëve të tyre, atëherë kur sjellja e tyre do të rrezikojë interesin më të lartë të fëmijës mund të vijë deri tek kufizimi i të drejtës prindërore. Në këto situata QPS me aktvendim mund ta marrë fëmijën nga njëri prind dhe ti'a besojë në ruajtje, kujdes dhe edukim prindit tjetër, ndonjë personi tjetër apo ndonjë institucion. Përkundër kësaj qendra do i obligojë prindërit që të ndjekin ndonjë këshillimore përkatëse.<sup>42</sup>

<sup>41</sup> Лилјана Спировиќ Трпеновска, Дејан Мицковиќ и Ангел Ристов (2013), Семејно Право, Скопје, Блесок, стр. 173/4

<sup>42</sup> По ату

Përveç marrjes së fëmijës nga njëri prind ose të dy prindërve ,kufizimi i të drejtës prindërore vjen në shprehje edhe me kufizimin e të drejtës për mbajtje të kontakteve personale midis prindit me të cilin nuk jeton fëmija dhe midis fëmijës, edhe kjo mund të zbatohet në rast se prindi i cili ka qenë i obliguar të paguajë alimentacionin për fëmijën këtë obligim nuk e ka kryer për më tepër se tre muaj atëherë QPS do të sjell aktvendim me të cilën do t'i'a kufizojë të drejtën për mbajtje të kontakteve deri në atë moment derisa sa ta kryejë obligimin.<sup>43</sup>

Gjithashtu QPS do të sjellë aktvendim me të cilën fëmijën e mitur do t'i'a jep në besim,ruajtje dhe kujdes prindit me të cilin nuk jeton fëmija edhe atë në qoftë se prindi i cili e ka kujdestarinë nuk e respekton vendimin e QPS dhe pengon mbajtjen e kontakteve mes prindit tjetër dhe fëmijës ,fëmijën do ia besojë për një periudhë të caktuar por jo më tepër se 15 ditë, edhe atë nqs prindi i cili e ka kujdestarinë e fëmijës më tepër se dy herë të njëpasnjëshme nuk e ka respektuar Vendimin e QPS-së , kjo është edhe pjesë shumë delikate dhe siç e pamë edhe tek rasti Mitovi kundër RM-së kjo masë nuk respektohet siç duhet në vendin tonë dhe jo çdoherë QPS bën mbikqyrje gjatë ushtrimit të të drejtës prindërore dhe aq më pak të merr një vendim të tillë , e cila në fakt duhet të ndërmmirret që të vijë deri tek vetdijsimi i prindit i cili e ka kujdestarinë e fëmijës që mos veprojë vetëm dhe mos e ushtrojë përgjegjësinë prindërore vetëm duke penguar prindin tjetër në ushtrimin e përgjegjësisë prindore dhe realizimin e të drejtës që është e garantuar si në mënyrë ligjore ashtu edhe me Konventë ndërkombëtare.

Pra QPS ka një rol tepër të rëndësishëm mirëpo në praktikë gjërat nuk zhvillohet ashtu siç duhet dhe këtë kompetencë që e ka nuk e trajton siç duhet dhe jo çdoherë arrin që të intervenojë në këto raste dhe të mbikëqyrë ushtrimin e të drejtës prindërore vazhdimisht.

Më të lehtë e kanë të sjellin aktvendim për kufizim të mbajtjes së kontakteve prindit i cili nuk e ka kujdestarinë për shkak të mospagimit të alimentacionit më shumë se tre muaj sepse e kanë më të lehtë të veprojnë në atë mënyrë sesa të sjellin aktvendim për dhënien e fëmijës në besim nga prindi i cili e ka kujdestarinë tek prindi tjetër edhe atë vetëm sepse prindi i cili e ka

<sup>43</sup> Po aty



kujdestarinë nuk e respekton vendimin e QPS-së dhe pengon prindin tjetër që të realizojë të drejtën e mbajtjes së kontakteve me fëmijën.

Përveç kësaj të rralla janë edhe rastet kur QPS i obligon prindërit që të ndjekin një këshillimore edhe duke ditur se vetëm në këtë mënyrë me këshillime mund të arrihet në qetësimin e mllefit të të dy prindërve dhe arritjen e një kompromisi për hir të interesit më të lartë të fëmijës.

### **3.2 Pasojat që shkakton shkurorëzimi i prindërve tek fëmijët në aspekt psikologjik.**

Shkurorëzimi si një dukuri mjaft e vështirë si për prindërit ashtu edhe për fëmijet. Mënyra e reagimit emocional të fëmijës varet se kujt moshe i përket pasi çdo moshë ka ndikimin e saj. Shumë fëmijë gjatë shkurorëzimit të prindërve përjetojnë trishtim, ankth, zemërim dhe kjo mund të shfaqet edhe në sjelljen e tyre. Gjatë periudhes së shkurorëzimit fëmijët mund të shfaqin shumë sjellje emocionale duke u mbyllur në vete, me regres, me lodhje fizike, me ndjenjën e fajit, veprime armiqesore, gjendje paniku, ankth etj <sup>44</sup>

Pa marrë parasysh gjininë e fëmijës ato e përjetojnë keq shkurorëzimin e prindërve. Kjo ndikon në sjelljen dhe gjendjen psikologjike të fëmijës e cila lë gjurmë në zhvillimin e personalitetit të fëmijës. Ndarja i vë në një pozitë jo të barabartë prindërit ndaj fëmijës, ku njëri prind do të jetojë me fëmijen kurse tjetri do e shohë varësisht se si ka vendosur QPS me aktvendimin për mënyrën dhe dinamikën e mbajtjes së kontakteve personale me fëmijët e mitur. Se si do jetë marrëdhënia e fëmijës me prindërit kryesisht me prindin i cili nuk e ka kujdestarinë varet edhe nga rrethi shoqëror, nga marrëdhënia midis të dy prindërve nga kultura, morali etj. Mendimi shkencor kryesisht sugjeronë që të dy prindërit të përfshihen në një periudhë më afatgjatë në përkujdesjen ndaj fëmijës. <sup>45</sup>

Se si ndikon shkurorëzimi i prindërve tek fëmijet varet edhe nga rrethi shoqëror ku jeton. Nëse fëmija rritet në një mjedis ku shkurorëzimi perceptohet si një dukuri normale, ku fëmija p.sh ka shumë moshatar në shkollë që i kanë prindërit e shkurorëzuar, që d.m.th ai fëmijë përballlet me moshatarët që janë në gjendje të njejtë, që përballen me situatë të njejtë

<sup>44</sup> [www.gazetadita.al](http://www.gazetadita.al) P.Kola publikuar më prill 2013

<sup>45</sup> Po aty

kupton se nuk është fëmija i vetëm që po përjeton diçka të tillë, atëherë posedon një lehtësim social , pra e ka më të lehtë ta pranojë këtë dukuri.<sup>46</sup>

Nëse fëmija rritet në një rreth shoqëror ku tema e shkurorëzimit është një temë tabu ku p.sh shkurorëzimi perceptohet si një dukuri shumë negative, shumë paragjykyese, perceptohet si një dukuri jo e pranueshme nga shoqëria , atëherë pasojat janë shumë të larta tek fëmijët pasi nëse rrethi shoqëror nuk mund ta perceptojë si diçka normale shkurorëzimin atëherë kultivon tek fëmija ndjenja të trishtueshme dhe parashtrojnë pyetje ne vetvete se përse ju ndodh vetëm prindërve të tij diçka e tillë?<sup>47</sup>.

Gjithashtu pasojat e shkurorëzimit tek fëmijët varen nga natyra e shkurorëzimit të prindërve, nëse prindërit janë shkurorëzuar në mënyrë paqësore pasojat psikike tek fëmija janë më të ulta, gjithashtu nëse prindërit janë shumë të kujdesshëm për mënyrën se si do ia interpretojnë fëmijës situatën në të cilën gjenden. Dukuria më e rëndësishme tek fëmija është plotësimi i nevojave shoqërore apo ekonomike pasi në periudhën e shkurorëzimit fëmijët gjithashtu përjetojnë ankth se kush do të kujdeset për to, kush do ia plotësojë nevojat e tij. Nëse këto situata janë të qartësuar tek fëmijët atëherë pasojat e shkurorëzimit tek to janë më të ulta.<sup>48</sup>

Nëse natyra e shkurorëzimit nuk ka qenë në mënyrë paqësore pasojat psikike tek fëmija janë mjaft të larta. Nëse prindërit gjithmonë grinden ndërmjet veti dhe aty është prezent fëmija pasojat janë mjaft të larta kryesisht mvaret edhe në bazë të moshës së fëmijës ,sepse e përjetojnë në mënyra të ndryshme p.sh nëse te kjo mënyrë e shkurorëzimit të prindërve është pjesë një fëmijë që ndodhet në moshën e adoleshencës atëherë ai fëmijë mund të reagojë në mënyra të ndryshme që mund të sjellin shumë pasoja tek fëmija si p.sh duke u larguar nga shtëpia pasi kërkon të gjejë qetësi në vende tjera ku atë qetësi nuk mund ta gjejë në shtëpinë e tij. Gjithashtu mund të shfaqet tek fëmija ndjenja e fajit ,duke menduar se ai është fajtor për shkurorëzimin e prindërve dhe për tejkalimin e kësaj ndjenje mund ta shtyjë drejt alkoolit dhe

<sup>46</sup> Nga intervista e realizuar me psikologun Elsa Selimi me date 15.02.2020

<sup>47</sup> Nga intervista e realizuar me psikologun Elsa Selimi me date 15.02.2020

<sup>48</sup> Po aty

kështu krijohet një person i varur nga alkooli, ose kyçet në veprime të tjera devijante siç janë vjedhjet e ndryshme dhe më pas edhe përdorimin e lëndëve narkotike etj. Të gjitha këto vijnë si pasojë e moskujdesit të sjelljes që e kanë prindërit pikërisht pas shkurorëzimit të martesës.<sup>49</sup>

Gjithashtu personat që kryejnë bullizëm nëpër shkolla sipas hulumtimeve një përqindje e madhe janë me prindër të shkurorëzuar. Pasi në periudhat kur fëmija duhet ta mësojë ndjenjen e dashurisë ku ajo kultivohet nga një familje e lumtur dhe e shëndoshë, kryesisht nga dashuria që e kanë prindërit ndërmjet veti, pra nëse fëmija nuk rritet me një model të një familjeje të lumtur që i jep dashuri, përkrahje atëherë fëmija nuk mund të arrijë që të krijojë një koncept se si duket një familje e shëndoshë. Gjithashtu është shumë e madhe përqindja që fëmijët që përjetojnë shkurorëzimin e prindërve në mënyrë negative dhe me shumë pasoja, të bëhen individë që nuk dëshirojnë të krijojnë familje pasi kanë shembull të drejtëpërdrejtë prindërit e tij dhe mënyrën se si kanë jetuar ata.<sup>50</sup>

Kapërcimi i pasojave tek fëmijët është shumë e vështirë, por mund të tejkalohet nëse prindërit veprojnë në mënyrë adekuate me fëmijët e tyre. Nuk ekziston një moshë e mirëfilltë se kur mund ta tejkalojë fëmija shkurorëzimin e prindërve pasi çdo moshë ka ndjeshmërinë e saj. Pa marrë parasysh se çfarë marrëveshje të arrihet ndërmjet prindërve nevoja e fëmijës duhet të ketë gjithmonë përparësi. Prindërit duhet ta shmangin betejën se kush do ta fitojë kujdestarinë ndaj fëmijës. Ato duhet të gjejnë një mes ku fëmija të mos e ndjejë shumë mungesën e njërit prind apo tjetrit.<sup>51</sup>

<sup>49</sup> Po aty

<sup>50</sup> Nga intervista e realizuar me psikologun Elsa Selimi me datë 15.02.2020

<sup>51</sup> [www.gazetadita.al](http://www.gazetadita.al) P.Kola publikuar më prill 2013

### **3.3. Interesi më i lartë i fëmijës**

Interesi më i lartë i fëmijës varet prej shumë faktorëve dhe nuk ka një definicion strikt se çfarë është interesi më i lartë i fëmijës. Mirëpo nënkuptohet që interesi më i lartë i fëmijës është që të rritet në një ambient të qetë, të shëndetshëm, të edukohet si duhet, të ndihet i lumtur në ambientin ku jeton, prindërit të kujdesen për të në mënyrë të barabartë, të kenë përgjegjësi të njejta për fëmijën, fëmija ka nevojë të ndihet mirë që prindërit e duan, për atë shkak rolin kyq për të përmbushur interesin më të lartë të fëmijëve e kanë prindërit e tyre.

Prindërit e fëmijëve duhet të kenë shumë kujdes se si flasin me njëri tjetrin pikërisht pas përfundimit të procedurës së shkurorëzimit, duhet të komunikojnë me njëri tjetrin sëbashku për të përmbushur kërkesat dhe nevojat e fëmijës edhe atë për të bërë atë që është më e duhura për fëmijën e tyre, duhet të kenë kujdes se si e edukojnë sepse prindërit janë shembulli që do të ndjekin fëmijët.

Prindërit duhet të lenë anash egon e tyre dhe mllëfin që kanë me njëri tjetrin dhe duhet të fokusohen në interesin më të lartë të fëmijëve, ku së bashku duhet të marrin çdo vendim që është më i miri për fëmijën edhe atë të zgjedhin vendin ose shtëpinë ku do të jetojë fëmija, në cilën shkollë do të edukohet, çfarë kursi do të ndjek, për aspektin shëndetësor se ku do të mjekohet, pra në përgjithsi gjithçka që ka të bëjë me fëmijën duhet bashkarisht t'i marrin vendimet dhe bashkarisht të vendosin.

Fëmijët duan që të jetojnë me të dy prindërit dhe për ta është shumë e vështirë që prindërit të shkurorëzohen, mirëpo në këto raste në qoftë se do të ketë mirëkuptim dhe bashkëpunim midis prindërve dhe fëmijëve këtë situatë fëmijët mund ta kalojnë më lehtë, sepse fundja me shkurorëzim mbaron vetëm martesë midis bashkëshortëve por jo edhe prindërimi, ata vazhdojnë ta duan fëmijën e tyre dhe mundohen që të veprojnë në mënyrën më të mirë për

fëmijën, mirëpo në rastet kur marrëdhëniet e ish bashkëshortëve janë tepër të prishura pikërisht atëherë shfaqen edhe problemet më të mëdha, sepse ata në ato momente nuk shikojnë të zbatojnë interesin më të lartë të fëmijës por veprojnë në bazë të interesave personale dhe fëmijën e përdorin si njëfarë arme për tu hakmarrë partnerit tjetër.

Në këtë mënyrë nuk duhet të veprohet asesi dhe për atë shkak duhet që prindërit sëbashku të ndjekin seanca këshilluese sidomos kur kanë fëmijë dhe të bashkëpunojnë që ta tejkalojnë këtë situatë më lehtë dhe fëmijës mos t'i lënë shumë pasoja dhe trauma pikërisht nga sjellja e tyre.

Pavarësisht se cilit prind do t'i jepet kujdestaria e fëmijëve, ata duhet të bashkëpunojnë me njëri tjetrin dhe duhet të respektojnë vendimet që i sjellin institucionet përkatëse, të lënë edhe prindin tjetër i cili nuk e ka kujdestarinë të kyçet në procesin e vendimmarrjes së përbashkët, fëmijët duhet të kenë marrëdhënie të pandërprera me prindërit edhe ma atë me të cilin nuk jeton, gjithashtu të ketë kontakte edhe me të afërmit e tjerë të familjes si p.sh gjyshin, gjyshen dhe anëtarët e tjerë më të afërt dhe është mirë që të mundohen prindërit që t'ia lehtësojnë fëmijës jetesën pas shkurorëzimit të tyre, duke e lënë kështu ta vazhdojë rutinën e tij të jetesës siç e ka patur, normalisht kur këto janë në interes më të lartë të fëmijës.

Fëmijët duhet të kalojnë kohë të barabarta me të dy prindërit dhe duhet të ndiejnë afërsinë dhe dashurinë e të dy prindërve, sëbashku me të dy prindërit të kalojnë kohë të mjaftueshme, sepse kjo është në interesin më të lartë të fëmijës, nëq të dy prindërit janë të përkushtuar ndaj fëmijës nuk ka arsye pse njëri prej tyre të privohet nga e drejta e mbajtjes së kontakteve ose e drejta e bashkëvendimmarrjes për më të mirën e fëmijës.

Mirëpo siç e pamë edhe sipas analizave të bëra se në RMV jo çdoherë prindërit vendosin në bazë të interesit më të lartë të fëmijës, por ata vendosin dhe veprojnë në bazë të interesit personal dhe hakmerren me njëri tjetrin duke bërë kështu fëmijën viktimë të këtij procesi të vështirë të jetës së tij. Këtë veprim prindërit e realizojnë edhe falë institucioneve përkatëse të cilët nuk veprojnë siç duhet dhe në vend që të vendosin sipas parimit të interesit më të lartë të fëmijëve ata vendosin sipas interesave personale të palëve, vendosin sipas anës ekonomike më të lartë dhe sipas pushtetit që e kanë nëpër institucionet përkatëse, gjë e cila është mjaft e ulët dhe kundër interesit më të lartë të fëmijës, sepse fëmijën askush nuk duhet ta ndalojë që të

sheh prindin tjetër me të cilin nuk jeton dhe të mbajë kontakte të rregullta dhe të pandërprera. Kjo gjë mund të kufizohet vetëm në qoftë se prindi është i papërgjegjshëm, abuzon me fëmijën dhe vepron kundër interesit më të lartë të tij.

### 3.4 Kujdestaria e fëmijëve të mitur në të drejtën komparative

Kujdestaria e fëmijëve të mitur pas shkurorëzimit të martesës rregullohet në të gjitha shtetet ndryshe edhe atë në bazë të legjislacioneve përkatëse dhe të gjitha shtetet janë të detyruara që në rast se prindërit janë të shkurorëzuar dhe fëmijët jetojnë vetëm me njërin prind edhe atë në shtet të ndryshëm nga ai në të cilin jeton prindi tjetër, fëmija në atë rast ka të drejtë që të mbajë kontakte dhe marrëdhënie direkte me të dy prindërit edhe atë fëmija ka të drejtë që të shkojë në shtetin ku jeton prindi tjetër dhe ai shtet është i obliguar që ta pranojë pa asnjë pengesë për shkak të interesit më të lartë të fëmijës që të mbajë kontakte dhe marrëdhënie personale me prindin tjetër me të cilin nuk jeton.<sup>52</sup>

Në të drejtën komparative varësisht se si e kanë të rregulluar me legjislacionin familjar shtetet veç e veç, edhe atë **në SHBA** disa shtete e kanë kujdestarinë e fëmijës të vetëm pra i jepet vetëm njërit prind (sole custody) dhe në qoftë se kujdestaria i jepet vetëm njërit prind, prindit tjetër i lejohet që të mbajë kontakte dhe ta vizitojë fëmijën, (sole custody) i jepet vetëm njërit prind vetëm kur kjo është në interesin më të lartë të fëmijës që të jetojë vetëm me njërin prind për shkak se prindi tjetër ka ushtruar dhunë dhe për shkak të problemeve devijante nuk mund të kujdeset për fëmijën siç duhet, gjithashtu edhe nëqë ka braktisur fëmijën dhe nuk ka dashur që ta kontaktojë, kurse disa kanë kujdestari të përbashkët të fëmijës (joint custody) ku të dy prindërit marrin vendime bashkërisht për më të mirën e fëmijës, mirëpo në çdo situatë kjo mund të jetë e ndryshme sepse varet shumë nga rasti konkret dhe me marrëveshjen që do e bëjë çdo çift edhe atë në marrëveshjen e shkruar (PLANI I PRINDËRIMIT).

<sup>52</sup> [www.children-and-divorce.com](http://www.children-and-divorce.com) marrë më 25.02.2020

Ky plan përmban informata se në cilën periudhë fëmija do të jetojë me njërin prind dhe në cilën periudhë me prindin tjetër ,ku shkruhet edhe se ku fëmija do t'i kalojë pushimet,festat,ditëlindjen ,gjithashtu në këtë plan mund të përmenden edhe vendimet e rëndësishme të jetës siç është shkolla,kujdesi shëndetësor,sportet,organizimet shoqërore etj, ky plan duhet patjetër të bëhet me shkrim ,të përmendet data e përpilimit dhe duhet të jetë l nënshkruar nga të dy prindërit.

Mirëpo në qoftë se prindërit nuk mund të arrijnë të bëjnë marrëveshje për kujdestarinë e fëmijës dhe mënyrën e realizimit të saj atëherë për kujdestarinë e fëmijëve të mitur do të vendosë gjyqtari në gjykatën familjare edhe atë në bazë të rastit konkret edhe interesit më të lartë të fëmijës, edhe pse në këto raste është shumë e vështirë të vendoset se cilit prind do i takojë kujdestaria , faktori kryesor është se cili prind është kujdesur më shumë për fëmijën , mirëpo gjyqtari do të merr parasysh edhe mendimin e fëmijës se ku ai dëshiron që të jetojë.<sup>53</sup>

Marrëveshja midis të dy prindërve për fëmijën varet shumë nga situata e prindërve edhe atë nga vendi ku jetojnë për arsye se në qoftë prindërit jetojnë afër njëri tjetrit do ta kenë më lehtë që fëmija të rrijë disa ditë tek nëna dhe disa ditë tek babai për të patur marrëdhënie të barabarta me të dy prindërit kjo mënyrë është më lehtë e zbatueshme vetëm kur prindërit e shkurorëzuar jetojnë në një vend afër njëri tjetrit , por kur prindërit jetojnë në vende të ndryshme edhe atë njëri në një qytet dhe tjetri në qytet tjetër më larg atëherë është më vështirë për fëmijën që të mbajë marrëdhënie të barabarta për shkak të largësisë dhe se nuk mundet që të ndyshojë shkollën disa ditë tek njëra dhe disa ditë tek shkolla tjetër.<sup>54</sup>

Në planin e prindërimit të dy prindërit mund të merren vesh që fëmija të jetojë me njërin prind dhe të shkojë në shkollë aty ku jeton ai prind kurse gjatë pushimeve dhe festave të jetojë me prindin tjetër , pra kjo varet nga vullneti që kanë të dy prindërit dhe nga mënyra e bashkëpunimit.<sup>55</sup>

<sup>53</sup> [www.family.findlaw.com](http://www.family.findlaw.com) marrë më 25.02.2020

<sup>54</sup> Po aty

<sup>55</sup> [www.divorceattorneynyc.com](http://www.divorceattorneynyc.com) marrë më 25.02.2020

Në qoftë se njëri prind largohet jashtë shtetit atëherë kujdestaria nga joint custody do të zbatohet siç ka qenë vetëm se fëmija do të vazhdojë të jetojë në vendin ku ka jetuar më parë me njërin prind për shkak se do e ketë më të vështirë për tu ambientuar në shtetin tjetër ku largohet prindi tjetër , dhe kjo bëhet vetëm për interesin më të lartë të fëmijës, ku përsëri prindërit së bashku do ta ushtrojnë të drejtën prindore .<sup>56</sup>

Kurse tek Shared Custody fëmija kalon kohë të barabartë me të dy prindërit 50-50 dhe në të dyja shtëpitë , edhe shtëpia e nënës edhe shtëpia e babait llogariten si shtëpi të tij. Varësisht prej shtetit ku jetojnë prindërit termi vizitë (mbajtja e kontakteve personale) nuk përdoret në këtë lloj të kujdestarisë për arsye se prindërit në mënyrë të barabartë e ushtrojnë të drejtën prindore dhe fëmija kalon kohë të barabartë si tek njëri prind ashtu edhe tek prindi tjetër.<sup>57</sup>

Pagesat që kanë të bëjnë për jetesën e fëmijës prindërit i bëjnë bashkarisht në mënyrë të barabartë mirëpo ndonjëherë kjo varet edhe nga financat që realizojnë ata pra ai që merr rrogë më të lartë do të paguajë më shumë kurse ai që merr rrogë më të ulët do të paguajë më pak , mirëpo kjo varet edhe nga koha që kalon fëmija me prindërit.

**Në Angli** kujdestaria e fëmijëve të mitur pas shkurorëzimit të martesës rregullohet në bazë të ligjit për kujdestarinë e fëmijës ,termi kujdestari tashmë mund të kuptohet se cila shtëpi do të jetë shtëpia e fëmijës , në shumicën e rasteve prindërit preferojnë JOINT CUSTODY e cila mundëson që fëmija të kalojë kohë të barabartë me të dy prindërit, ky opsion gjithashtu mundëson që të dy prindërit të marrin pjesë në vendimet që mund të ndikojnë tek fëmija , mirëpo në qoftë se prindërit nuk arrijnë që të bëjnë marrveshje atëherë gjyqtari do të vendos në lidhje me kujdestarinë e fëmijës. Mirëpo nuk është e caktuar me dispozita ligjore se fëmijët duhet të jetojnë vetëm me nënën ose vetëm me babain, në qoftë se prindërit nuk mund të arrijnë marrëveshje , u ofrohet të shkojnë në MEDIACION , mirëpo nqs edhe ajo nuk funksionon atëherë do të përfshihet gjykata dhe gjyqtari do të vendosë se si është më e përshtatshme për fëmijën. Në disa raste njërit prind mund ti kufizohet e drejta prindërore dhe të përjashtohet nga kujdestaria e fëmijës në qoftë se kjo është në interesin më të lartë të fëmijës edhe atë në qoftë

<sup>56</sup> [www.custodyexchange.com](http://www.custodyexchange.com) marrë më 25.02.2020

<sup>57</sup> [www.legalmatch.com](http://www.legalmatch.com) marrë më 25.02.2020



se njëri prind abuzon me fëmijën , ndikon negativisht në sjelljen dhe edukimin e fëmijës etj. Mirëpo përsëri në qoftë se ndryshojnë rrethanat gjykata ka të drejtë që ta ndryshojë vendimim dhe përsëri ta lejojë prindin që të ketë kujdestarinë e fëmijës.

Gjykata do të shqyrtojë planin që e kanë bërë prindërit për fëmijën edhe atë do ta aprovojë vetëm në qoftë se është në interesin më të lartë të fëmijës , do të merr parasysh edhe gjendjen emocionale ose afirmitetin që e ka fëmija me gjyshërit ose anëtarët tjerë të afërm të familjes për arsye se edhe ata mund të luajnë rol shumë të madh në jetesën e fëmijës.(Anna Martin 2020 )<sup>58</sup>

**Në Spanjë** kujdestaria e fëmijës i jepet njërit prind , edhe atë në të shumtën e rasteve kujdestaria l jepet nënës , mirëpo në qoftë se nëna është e paaftë që të kujdeset për fëmijën atëherë mund të kërkohet që kjo e drejtë ti hiqet dhe kujdestarinë ta merr prindi tjetër.Pas mbushjes së moshës 13vjet, gjykata mund të merr parasysh edhe mendimin e fëmijës. Gjykata kujdestarinë ia jep nënës në bazë të analizave të bëra në përkushtimin e secilit prind ndaj fëmijëve, kur njëri prej prindërve do të merr kujdestarinë ligjore të fëmijëve atëherë prindit tjetër do ti lejohet mbajtja e kontakteve direkte me fëmijën i cili prind është i obliguar që të paguajë edhe shumën e alimentacionit për fëmijën çdo muaj. Prindi i cili nuk e ka kujdestarinë e fëmijës ka edhe disa të drejta dhe detyrime tjera edhe atë: të kujdeset për edukimin, kujdesinn shëndetësor dhe sigurimin e fëmijës të përfshihet në vendimet që merren për të ardhmen e fëmijës, të informohet për çdo incident dhe emergjencë në jetën e fëmijës,të respektojë vizitat që i lejohet dhe të mbajë kontakt me fëmijën.

Mirëpo në rast të JOINT CUSTODY prindërve u jepet mundësia për një kujdestari të përbashkët të cilët marrin vendime të përbashkët për mirëmbajtjen e fëmijëve të tyre dhe koha e kaluar me ta do të jetë e barabartë që domethënë ata mund të jetojnë me një prind për një kohë dhe me prindin tjetër për një kohe, përveq rasteve kur kjo lloj kujdestaria konsiderohet si e pa përshtatshme dhe nuk e plotëson interesin më të lartë të fëmijës. Për tu aprovuar JOINT

<sup>58</sup> [www.childsupportlaws.co.uk](http://www.childsupportlaws.co.uk) – marrë më 29.02.2020

CUSTODY gjykata patjetër duhet të ketë raport ose provë që tregon se nuk ka patur dhunë në familje.<sup>59</sup>

**Në Itali** prindërit mund të merren vesh që pas shkurorëzimit të martesës të drejtën prindore ta ushtrojnë bashkarisht mirëpo kjo marrëveshje duhet të miratohet nga ana e gjykatës e cila vlerëson se a l përshtatet marrëveshja e sjellur interesit në të lartë të fëmijës.<sup>60</sup>

Gjykata mund të sjellë vendim ku njëri prind vetëm të mund ta ushtrojë të drejtën prindore , pra të ketë të drejtë ekskluzive, ku prindi me të cilin jeton fëmija l sjell të gjitha vendimet kurse për ato më të rëndësishmet duhet të ketë pëqim edhe prej prindit tjetër,prindi me të cilin nuk jeton fëmija ka të drejtë mban kontakte personale me fëmijën , kalon kohë të mjaftueshme si dhe është l informuar për gjithçka që ka të bëjë me fëmijën,gjykata gjithashtu nqs kanë kontest partneret vendos se me cilin prind do të jetojë fëmija,si do të realizohen kontaktet mes prindit me të cilin nuk jeton fëmija dhe fëmijës ; si dhe gjykata mund të sjellë vendim që sëbashku të dy prindërit ta ushtrojnë të drejtën prindërore në qoftë se të dy prindërit pajtohen së bashku për këtë lloj të ushtrimit të së drejtës prindërore.<sup>61</sup>

Në Itali gjithashtu është e paraparë që fëmija të shprehë mendimin e vet në të gjitha procedurat në të cilat vendoset përzhvillimin e drejtë të fëmijës.Gjyqtari do t'i merr parasysh mendimet dhe dëshirat e fëmijës në bazë të pjekurisë së arritur.<sup>62</sup>

Në *Zvicër* prindërit e ushtrojnë bashkarisht të drejtën prindore , kurse gjykata me vendim do të vendosë për ushtrimin e të drejtës prindore , edhe atë ushtrimin e të drejtës prindore mund t'ia besojë njërit prind ose të dy prindërve në mënyrë të përbashkët ta ushtrojnë të drejtën prindërore. Edhe atë vendimi merret duke patur parasysh se cili prind mund të ofrojë kushte më të mira për zhvillimin e fëmijës dhe ti ofrojë jetesë më stabile fëmijës .Nqs prindërit të drejtën prindore e ushtrojnë bashkarisht duhet kërkesën ta parashtojnë në gjykatë dhe të bëjnë

<sup>59</sup> [www.lawyersspain.eu](http://www.lawyersspain.eu) – Federicco Richardson publikuar më 18.04.2016

<sup>60</sup> Emine Zendeli,Arta Selmani Bakiu,Dejan Mickoviq,dhe Angel Ristov (2020), E drejta familjare,Tetovë,faq.238

<sup>61</sup> По ату

<sup>62</sup> Дејан Мицковиќ и Милица Шутова(2020),Разводот на брак во Европските земји , ДГУП “Софија” Богданци , стр.285

një marrëveshje në formë të shkruar ku do të cekin të gjitha vendimet dhe mënyrën e kujdesit që do të realizojnë për fëmijën , ku gjykata do të vlerësojë se a e plotëson marrëveshja e tillë interesin më të lartë të fëmijës.<sup>63</sup>

*Kroacia* promovon ushtrimin e përbashkët të së drejtës prindërore , ku partnerët duhet të përpilojnë planin e prindërisë së përbashkët i cili duhet të miratohet nga ana e gjykatës si dhe prindërit duhet ta informojnë fëmijën për përmbajtjen e planit dhe të marrin edhe mendimin e fëmijës varësisht prej moshës dhe pjekurisë duke respektuar kështu mendimin e fëmijës.Kroacia gjithashtu ka një mundësi për zgjidhje alternative të kontesteve për kujdestarinë e fëmijëve pas shkurorëzimit të martesës , edhe atë në bazë të Medijacionit ku do të këshillohen prindërit përpara se të shkojnë në gjykatë , e cila është një mundësi mjaft e mirë.<sup>64</sup>

Në *Austri* prindërit mund të merren vesh që bashkarisht ta ushtrojnë të drejtën prindërore, por nqs kërkon njëri nga prindërit dhe është në interesin e fëmijës atëherë gjykata mund mund të sjellë vendim që vetëm njëri nga prindërit të ushtrojë të drejtën prindërore, si dhe me rëndësi të veçantë është se fëmija duhet të dëgjohet oara se të caktohet se me cilin prind do të jetojë fëmija .Gjyqtari e degjon mendimin e fëmijës së mitur i cili i ka mbushur 10 vjet ,kurse fëmijët më të vegjël mund të dëgjoen nga ana e ekspertëve psikologë dhe pedagogë.<sup>65</sup>

Në *Gjermani* në qoftë se prindërit jetojnë të ndarë të drejtën prindërore vazhdojnë ta ushtrojnë sëbashku, por edhe secili nga prindërit mund të kërkojë që vetëm njëri ta ushtrojë të drejtën prindërore dhe gjykata mund të vendosë që fëmijën t'ia besojë vetëm njërit prind ,në qoftë se për këtë ekzistojnë arsye të bazuara dhe ky vendim mund të jetë në interesin më të lartë të fëmijës.<sup>66</sup>

<sup>63</sup> <sup>63</sup> Emine Zendeli,Arta Selmani Bakiu,Dejan Mickoviq,dhe Angel Ristov (2020), E drejta familjare,Tetovë,faq.241

<sup>64</sup> Emine Zendeli,Arta Selmani Bakiu,Dejan Mickoviq,dhe Angel Ristov (2020), E drejta familjare,Tetovë,faq.242

<sup>65</sup> Дејан Мицковиќ и Милица Шутова(2020),Разводот на брак во Европските земји , ДГУП “Софија” Богданци , стр.282,286.

<sup>66</sup> Дејан Мицковиќ и Милица Шутова(2020),Разводот на брак во Европските земји , ДГУП “Софија” Богданци , стр.283.

Në *Çeki* me shkurorëzimin e martesës gjykata sjell vendim fëmija t'i besohet njërit prind kurse prindi tjetër detyrohet të paguajë alimentacionin. Gjykata këtë mund ta bëjë me kërkesë të njërit prej prindërve por edhe me detyrë zyrtare. Në bazë të legjislacionit Çek ndryshimi për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore mund të bëhet vetëm me vendim të sjellur nga ana e Gjykatës.<sup>67</sup>

Në *Suedi* të drejtën prindërore prindërit e ushtrojnë bashkarisht duke respektuar kështu interesin më të lartë të fëmijës, pra bashkarisht kujdesen për ruajtjen dhe edukimin e fëmijës, kanë të drejta dhe obligime të barabarta. Gjykata ua beson ushtrimin e të drejtës prindërore të dy prindërve për të plotësuar interesin më të lartë të fëmijës dhe fëmija kalon kohë të barabarta me të dy prindërit, dhe zakonisht ky model është shumë i sukseshëm dhe ka efekte pozitive edhe prindërit edhe tek fëmijët, por me kërkesë të njërit prej prindërve gjykata mund të vendosë që edhe vetëm njëri prind ta ushtrojë të drejtën prindërore.<sup>68</sup>

<sup>67</sup> Po aty.

<sup>68</sup> Emine Zendeli, Arta Selmani Bakiu, Dejan Micković, dhe Angel Ristov (2020), E drejta familjare, Tetovë, faq. 240

### 3.5. Joint Custody-Prindëria e përbashkët

\*Disa nga dokumentet ndërkombetare që e rregullojnë prindërinë e përbashkët pas shkurorëzimit të martesës janë: Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për realizimin e të Drejtave të Fëmijëve, Konventa për kontaktet me fëmijën, Konventa e Hagës mbi juridiksionin, ligjin e zbatueshëm, njohjen, ekzekutimin dhe bashkëpunimin në lidhje me përgjegjësinë prindërore dhe masat për mbrojtjen e fëmijëve, Rregullorja Bruxelles II bis etj.<sup>69</sup>

Dokumenti ndërkombëtar i cili është më i rëndësishëm dhe garanton të drejtën e fëmijës së mitur për të jetuar me të dy prindërit është Konventa për të drejtat e fëmijës e cila promovon parimin e respektimit të interesit më të lartë të fëmijës për të jetuar me të dy prindërit, mbajtja e kontakteve dhe raporteve të rregullta mes prindërve të shkurorëzuar dhe fëmijëve, të drejtën e fëmijës për të shprehur mendimin e tij varësisht moshës dhe pjekurisë së fëmijës.<sup>70</sup>

Konventa promovon respektimin e interesit më të lartë të fëmijës, ku gjykata do vendosë nëse do t'ia besojë fëmijën njërit prind, apo do të sjellë vendim për prinderi të përbashkët, varësisht nga fakti se për cilin model do të vlersojë se është në interesin më të lartë të fëmijës.<sup>71</sup>

Fëmijët mund të jetojnë të ndarë nga prindërit e tyre vetëm në raste të veçanta kur ky veprim është në interesin më të lartë të fëmijës.

<sup>69</sup> Emine Zendeli, Arta Selmani Bakiu, Dejan Micković, dhe Angel Ristov (2020), E drejta familjare, Tetovë, faq. 247

<sup>70</sup> Po aty.

<sup>71</sup> Po aty

Instituti Joint Custody ose prindëria e përbashkët është një lloj i kujdestarisë në të cilën të drejtat dhe obligimet u takojnë të dy prindërve . Joint Custody mund të jetë kujdestari e përbashkët fizike , kujdestari e përbashkët juridike ose e kombinuar.

Kujdestaria e përbashkët fizike ose (Shared Parenting) është kujdestaria kur fëmijët shpenzojnë kohë të barabartë me të dy prindërit këtë rast e përmendëm edhe më lartë).

Kujdestaria e përbashkët juridike – të dy prindërit e fëmijës ndajnë vendimmarrjet se ku do të shkollohet fëmija, ku do të zhvillojë kujdesin shëndetësor, edukimin fetar etj.

Tek kujdestaria e kombinuar e përbashkët ku fëmija p.sh jeton me njërin prind kurse prindi tjetër do të merr vendime sëbashku me prindin me të cilin jeton fëmija dhe bashkarisht do të kryejnë funksionet për jetesën më të mirë të fëmijës dhe plotësimim e interesit më të lartë të fëmijës.<sup>72</sup>

#### **Përparsitë e JOINT CUSTODY janë:**

- Fëmija është në gjendje që të rritet në ndikimim dhe përkujdesin e të dy prindërve,të dy prindërit bashkarisht marrin vendime ligjore për fëmijën si dhe për të jetuar bashkë me fëmijën.
- Fëmija mund të jetë pika e përbashkët për prindërit pas shkurorëzimit të martesës , çiftet e shkurorëzuar duhet të punojnë sëbashku nqs kanë kujdestari të përbashkët të fëmijës së tyre, edhe pse marrëdhëniet midis tyre nuk është se janë të mira mirëpo të dy prindërit përpiqen që ta rregullojnë marrëdhënien e tyre vetëm për shkak të interesit të fëmijës.
- Të dy prindërit kanë më pak stres dhe përgjegjësi me kujdestarinë e përbashkët, rritja e një fëmije dhe marrja e vendimeve të rëndësishme për jetën e fëmijës mund të jetë e vështirë nqs bëhet vetëm nga njëri prind , për atë shkak kujdestaria e përbashkët ndikon në ndarjen e përgjegjësisë.

<sup>72</sup> [www.liveabout.com](http://www.liveabout.com) marrë më 29.02.2020

### **Mangësitë e JOINT CUSTODY:**

- Kujdestaria e përbashkët fizike(Shared Parenting) u jep mundësinë fëmijëve për të jetuar me të dy prindërit. Kjo mund të jetë stresuese për fëmijët që të lëvizin vazhdimisht nga shtëpia në shtëpi, sidomos për fëmijët më të vegjël .
- Kujdestaria e përbashkët e fëmijët nuk funksionon për çdo çift të shkurorëzuar sepse për disa kujdestaria e përbashkët mund të sjellë më shumë zënka dhe grindje në lidhje me marrjen e vendimeve të rëndësishme apo edhe të përditshme për fëmijën.
- Ndonjëherë kujdestaria e përbashkët e fëmijës nuk është e duhur për shkak se një prind mund të jetë më i përgjegjshëm se prindi tjetër.<sup>73</sup>

### **Disa rregulla për funksionimin e kujdestarisë së përbashkët:**

- Prindërit nuk duhet t'i flasin keq fëmijës për prindin tjetër, edhe pse prindërit mund të kenë probleme me njëri tjetrin dhe nuk mund ta durojnë njëri tjetrin duhet që të kenë kujdes në sjelljen e tyre për shkak se fëmija i do të dy prindërit njëllot.
- Shkurorëzimi ka të bëjë vetëm me mbarimin e martesës dhe jo edhe me mbarimin e përgjegjësisë prindërore , kujdestaria e përbashkët funksionon më mirë kur të dy prindërit lënë menjatë egon e tyre dhe përqendrohen se ajo që është më e mira për fëmijën nuk është gjithmonë më e mira për interesin e prindërve.
- Të dy prindërit duhet të jenë real dhe të përkushtuar në maksimum për të plotësuar interesin më të lartë të fëmijës.
- Të dy prindërit duhet që të bëjnë marrëveshje të përbashkët në bazë të rastit të tyre konkret.
- Së bashku mund të bëjnë një orar në të cilin do të parashikojnë se sa kohë mund të shpenzojnë fëmijët me njërin prind dhe sa kohë me prindin tjetër, sidomos kur fëmijët

<sup>73</sup> [www.divorcenet.com](http://www.divorcenet.com) marrë më 29.02.2020

janë në moshë më të madhe dhe vetse i kanë oraret dhe planet e tyre varësisht prej detyrimeve , kurseve ,sporteve etj.

- Bashkëshort/e t i/e keq/e nuk d.m.th prind i keq, edhe pse jeta martesore nuk ka qenë e shkëlqyer por prindërimi mund të jetë i suksesshëm, fëmija ka dëshirë dhe nevojë për dashurinë e të dy prindërve dhe ajo mund të funksionojë vetëm në qoftë se prindi i vendos nevojat e fëmijëve si primare.
- Duhet gjetur mënyra e duhur për komunikim midis prindërve, për arsye se komunikimi është funksioni kyq për funksionimin e JOINT CUSTODY.
- Prindërit duhet të shmangin konfliktet përpara fëmijëve të tyre.
- Prindërit duhet të marrin parasysh mendimin dhe dëshirat e fëmijës.(Kate Bayless)<sup>74</sup>

<sup>74</sup> [www.parents.com](http://www.parents.com) marrë më 29.02.2020



### 3.6. Ushtrimi i së drejtës prindërore në të drejtën komparative

Ushtrimi i të drejtës prindërore në të drejtën komparative nuk është e rregulluar njëjtë në të gjitha shtetet, pra varet se çfarë lloji të kujdestarisë kanë prindërit p.sh në qoftë se njëri prind ka edhe joint legal custody edhe physical custody atëherë ai vet vendos për fëmijën dhe merr vendime, mirëpo kur prindi tjetër ka edhe legal custody atëherë prindi i cili e ka kujdestarinë është i obliguar që të merr mendime edhe prej prindit tjetër dhe bashkarisht të vendosin për interesin më të lartë të fëmijës. Mirëpo në të dyja rastet prindi i cili nuk e ka kujdestarinë e fëmijës nuk i humbet e drejta për ta vizituar dhe për të mbajtur kontakte me fëmijën. Një shembull të kujdestarisë së vetme (sole custody) kemi atëherë kur p.sh Nëna dhe babai janë shkurorëzuar për shkak të abuzimit dhe varësisë së babait dhe nëna kërkon dhe i jepet kujdestaria e vetme e fëmijës (sole custody) dhe kjo d.m.th që nëna ka të drejtë të vendos për çështjet kryesore në lidhje me edukimin e fëmijës dhe fëmija do të jetojë vetëm me nënën kurse babai ka të drejtë vetëm për ta vizituar fëmijën. Kur është në pyetje Sole custody dhe zhvendosja e prindit nga njëri vend në tjetrin edhe pse prindi ka kujdestari të vetme përsëri nuk mund të largohet pa lejen e gjyqit sepse në qoftë se prindi tjetër ka të drejtë për ta vizituar fëmijën atëherë në këtë rast mund t'i pengohet e drejta për të vizituar fëmijën për shkak të distancës dhe për atë shkak kjo është një çështje që duhet të zgjidhet nga gjykata.<sup>75</sup>

Në të shumtën e rasteve në të drejtën komparative prindërit së bashku dhe me marrëveshje e ushtrojnë të drejtën prindërore dhe mundohen që të lënë anash preferencat ose egon e tyre dhe primare e vëndojnë interesin më të lartë të fëmijës, duke komunikuar dhe duke marrë çdo vendim me marrëveshje edhe atë: se ku do të jetojë fëmija, në cilën shtëpi, si do t'i zhvillojnë marrëdhëniet, ku do të shkojë në mjek. Çfarë sporti do të zhvillojë, në çfarë kursi do të shkojë

<sup>75</sup> [www.family.findlaw.com](http://www.family.findlaw.com) marrë më 29.02.2020

fëmijët, çështjet tjera që kanë të bëjnë me fëmijën ,pra gjithçka mundohen që të zgjedhin bashkarisht dhe me marrëveshje vetëm për të përmbushur interesin më të lartë të fëmijës. Ushtrimi i së drejtës prindërore vetëm nga njëri prind bëhet vetëm në raste të veçanta edhe atë siç e përmendëm më lartë dhe kjo bëhet në qoftë se është më mirë për interesin më të lartë të fëmijës.

## **KAPITULLI I KATËRT:**

### **4.DE LEGE FERENDA**

Legjislacioni familjar I RMV-së ka nevojë për disa ndryshime të cilat duhet të bëhen në këto institute :

- ☉ ***Mundësia për prindëri të përbashkët (JOINT CUSTODY)***
- ☉ ***Përgjegjësia Prindërore*** të vendoset në vend të së drejtës prindërore
- ☉ ***Vendosja e Psikologut Gjyqesor për funksionim me efikas në zgjidhjen e çështjeve familjare me qëllim të caktimit të kompetencës gjyqatës dhe mosngarkimit të qendrës për punë sociale e cila është e stërngarkuar dhe nuk është efikase sepse të punësuarit nuk janë të kualifikuar si duhet profesionalisht si dhe ka pak të punësuar dhe ka shumë raste të cilët nuk mund të arrijnë që të vendosin drejtë dhe në mënyrë të arsyeshme.***
- ☉ ***Vendosja e Sektoreve këshilluese –këshillimore familjare për të mbajtur seanca këshilluese me prindërit kur vendosin të shkurorezohen lidhur me kujdestarinë e fëmijëve , këshillimi për të drejtat dhe obligimet që I kanë ndaj fëmijëve , interesi I fëmijës të jetë primar .Do të ishte mirë që të gjitha kompetencat e QPS-së në lidhje me kontestet martesore ti delegoheshin kësaj këshillimore familjare për të patur një efekt sa më të mirë.***
- ☉ ***Medijacioni*** si mundësi për zgjidhjen e konflikteve (kontesteve)familjare në mënyrë paqësore.Me anë të medijacionit të mund të shkurorezohet martesa me marrëveshje

*dhe duke patur parasysh se procedurat gjyqësore zgjasin shumë ,kjo mënyrë do të shërbejë për zgjidhje më të shpejtë të martesës,procedure më efikase dhe efekt më të mirë për arsye se të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me vazhdimësinë e përgjegjësisë prindore pas shkurorëzimit do të jenë më të lehta të zgjidhen në këtë procedure, gjithashtu edhe për palët do të jetë më e lehtë dhe më pak stresuese se nuk do të përballen me hapësirat e gjyqit të cilat u japin një ndjenjë stresuese palëve.*

Këto janë disa rekomandime të cilat unë I propozoj si reforma të ardhshme të cilat mund të ndihmojnë në përmirësimin e efikasitetit të gjykatave, intitucioneve të tjera që merren me çështjet familjare , të shoqërisë , dhe të arrihet deri tek vetdijësimi I qytetarëve ,prindërve dhe konfliktet familjare të zgjidhen në mënyrën më të mirë të mundshme duke u zbatuar parimi i respektimit me të lartë të interesit të fëmijës.

Nga kjo do të ndalem që të hartoj pikën e parë që ka të bëjë me ndryshimin Për vendosjen e mundësisë për prindëri të përbashkët (Joint Custody) e cila ka gjetur zbatim dhe funksionon mjaft mirë në shumë shtete, disa prej tyre i përmendëm edhe më lartë se si funksionon ky institut atje.

Duhet të vendoset dispozitë ligjore e cila do të jetë kështu:

***“ Edhe në rast se shkurorëzohet martesa të dy prindërit duhet të vazhdojnë që ta ushtrojnë përgjegjësinë e tyre prindërore dhe së bashku me marrëveshje t’i sjellin të gjitha vendimet që kanë të bëjnë për ardhmërinë dhe jetën më të mirë të fëmijës duke e zbatuar dhe respektuar interesin më të lartë të fëmijës”.***

Në këtë mënyrë të dy prindërit janë të barabartë dhe të dy obligohen që në mënyrë të barabartë të kujdesen për fëmijën dhe ta ushtrojnë përgjegjësinë prindërore bashkarisht dhe jo siç është në vendin tonë ku njërit prind i jepet në kujdestari fëmija dhe prindi tjetër ka vetëm të drejtë në mbajtjen e kontakteve të përcaktuara dhe obligim për pagesën e alimentacionit , konsideroj se në këtë rast njërit prind i bëhet diskriminim dhe vetëm prindit të cilit I takon kujdestaria e fëmijës i jepen të gjitha

privilegjet dhe i gjithë pushteti dhe autoriteti që të vendos për gjithçka që ka të bëjë me fëmijën dhe mendimin e prindit tjetër as nuk e përfill, gjë e cila është mjaft diskriminuuese dhe jo e drejtë për arsye se të dy prindërit duhet bashkarisht dhe me marrëveshje ta ushtrojnë përgjegjësinë prindërore.

Me anë të Institutit Shared Custody 50-50 , fëmija do të ketë komoditetin që të rritet me të dy prindërit në mënyrë të barabartë dhe të kalojë kohë me të dy prindërit p.sh 6 muaj te njëri prind dhe 6 muaj te prindi tjetër , mirëpo kjo mënyrë nuk mund të zbatohet në qoftë se njëri prind jeton në një qytet dhe prindi tjetër në qytet tjetër, për shkak të distancës nuk mund të funksionojë siç duhet ky institute se fëmijët nuk mundën që të shkojnë 6 muaj në njërën shkollë dhe 6 muaj në shkollën tjetër , me këtë do të bëhej një çekuilibrim në jetën e fëmijës dhe do të ndikonte negativisht.

Mirëpo në vendin tonë mund të funksionojë siç duhet Instituti JOINT CUSTODY ku prindërit do të kenë kujdestari të përbashkët dhe sëbashku do të merren vesh për të gjitha vendimet që duhet t'i sjellin për ardhmërinë e fëmijës së tyre duke zbatuar interesin më të lartë , përsëri fëmija mund të jetojë në shtëpinë e njërit prind mirëpo të ketë përkrahjen dhe afërsinë edhe të prindit tjetër në çdo kohë që ka nevojë dhe të jetë i përfshirë edhe prindi tjetër edhe në vendimmarrje të përbashkët por edhe për të kaluar kohë të mjaftueshme me fëmijën ,për fundjavë ,për festa, për pushime etj.Fëmija të mund të jetojë edhe tek shtëpia e prindit tjetër nqs dëshiron të kalojë kohë të mjaftueshme me prindin tjetër dhe çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën të merret me marrëveshje midis të dy prindërve dhe në konsultim me fëmijën.

Më ka mbetur mjaft përshtypje e mirë nga një emision në Tv Klan në Shqipëri edhe atë tek emisioni “RUDINA” ku ishin të ftuar një çift të cilët ishin të shkurorëzuar dhe kishin një fëmijë të përbashkët , prindërit treguan për përvojën e tyre dhe mënyrën se si vepronin ata , gjë e cila ishte vërtet për tu admiruar se edhe pse ata ishin të shkurorëzuar përsëri për të plotësuar interesin më të lartë të fëmijës i kalonin fundjavat sëbashku ku dëshironte fëmija , vizitonin lokalit dhe restorantin ku dëshironte fëmija e tyre, sëbashku i merrnin të gjitha vendimet për fëmijën dhe fëmija mundeshte që ta

takojë prindin tjetër në çdo kohë që të dëshironte ai , pra edhe planin e tyre ditor dhe javor e bënin në bazë të kërkesave të fëmijës dhe duke u munduar që synim primar ta kenë respektimin e interesit të fëmijës dhe jo interesin e tyre personal . Kjo është mënyrë mjaft e mirë e veprimit dhe i jep hapësirë fëmijës që të mendojë që përsëri prindërit e duan të dy njëloj , dhe në këtë mënyrë nuk e përjeton aq me stres ndarjen e prindërve të tyre sepse kalon kohë të mjaftueshme me të dy prindërit , krijon marrëdhënie shumë të mira dhe shikon që prindërit arrijnë të bisedojnë dhe të bëjnë kompromise për hir të interesit të fëmijës.Gjithashtu edhe për prindërit është mirë sepse të dy kanë përgjegjësi dhe obligime të njejta për fëmijën ,sëbashku e ushtrojnë përgjegjësinë prindërore, sëbashku sjellin vendime dhe kjo nuk e diskriminon as njërin prind dhe as prindin tjetër.

Në vendin tone duhet të ndryshohet neni 80 paragafi I dytë I Ligjit për familje të RMV-së I cili duhet të jetë në këtë mënyrë:

***“Në qoftë se prindërit nuk munden që të merren vesh për mirëmbajtjen e fëmijëve dhe kushtet për mbajtjen e tyre, ose në qoftë se marrëveshja e tyre është në kundërshtim të interesit më të lartë të fëmijës ,atëherë do të vendos gjykata në bazë të mendimit të dhënë nga ana e psikologut gjyqsor I cili duhet të ketë mbajtur disa seanca me prindërit dhe fëmijët në bashkëpunim me këshillimoren familjare, gjykata në këtë rast do të vendos që në qoftë se të dy prindërit janë të përkushtuar ndaj fëmijëve atëherë prindërit të kenë kujdestarinë e përbashkët ndaj fëmijës, pra fëmijën ta mbajnë në mënyrë të barabartë dhe të kujdesen bashkarisht për edukimin , mirëqënien, shëndetin duke e respektuar interesin më të lartë të fëmijës”.***

## 5.Konkluzione

Sipas problemeve që trajtuam në këtë punim u konstatua se në vendin tonë nuk funksionon siç duhet kjo mënyrë e dhënies së kujdestarisë vetëm njërit prind për arsye se të drejtën prindore në mënyrë të plotë e ushtronte prindi i cili e kishte kujdestarinë e fëmijës dhe nuk merrte parasysh aspak mendimin e prindit tjetër dhe nuk lejonte që prindi tjetër të merr pjesë në vendimarrje për çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën .

Pamë raste se si realizohet kjo në praktikë ku u konstatua se shumica e prindërve që kishin kujdestarinë e fëmijës e pengonin prindin tjetër që ta shikojë fëmijën dhe të realizojë të drejtën e tij për mbajtje të kontakteve të drejtpërdrejta dhe mbajtjen e marrëdhënieve personale me fëmijën.

Qendra për Punë Sociale në të shumtën e rasteve nuk e kryente siç duhet punën e saj dhe ekipi profesional nuk vendoste sipas standardeve dhe metodologjisë që duhej të veprojnë.

Në vendin tonë rastet zgjidhen më së shumti në bazë të interesit të palëve dhe jo në bazë të interesit më të lartë të fëmijës , gjë e cila u dëshmuar edhe me rastet konkrete që u trajtuan.

Dhënia e kujdestarisë në mënyrë tradicionale vetëm njërit prind ka tepër pakënaqësi në këtë sistem dhe vetëm nqs ndyshohet kjo mënyrë atëherë do të zbatohet interesi më i lartë i fëmijës.

Prindërit nuk bashkëpunonin midis vete dhe nuk kishin marrëdhënie miqësore me njëri tjetrin për të plotësuar interesin më të lartë të fëmijëve dhe për këtë shkak fëmijët kanë pasoja të mëdha nga kjo proces jetësor në të cilën jetojnë falë prindërve të tyre.

QPS nuk bën mbikëqyrje të rregullt të të drejtës prindore dhe për atë shkak aktvendimet që i sjell mbeten të parealizuara dhe në vend që ti obligojë prindërit që të ndjekin seanca këshilluese ata vetëm i informojnë dhe prej këtyre mosveprimeve nuk respektohet interesi më i lartë i fëmijëve por vetëm vërtetohet interesi i palëve në luftën që e zhvillojnë me njëri tjetrin .

E pamë që favorizohej vetëm prindi i cili e kishte kujdestarinë e fëmijës, kurse prindi tjetër edhe përkundër të drejtës që e ka për mbajtjen e kontakteve personale me fëmijën në shumicën e rasteve privohej nga kjo e drejtë për arsye se prindi tjetër nuk e lejonte që të takojë fëmijët ose edhe duke patur parasysh vendimin që e sjell QPS ku caktohen kontakte shumë të pakta midis prindit me të cilin nuk jeton fëmija dhe fëmijës së mitur.

## **6.Rekomandime**

Përveç rekomandimeve të lartëpërmendura në DE LEGE FERENDA , do të doja të shtoj se në RMV duhet të mbahen ligjërata dhe trajnime edukuese për të gjithë prindërit se si duhet të

edukojnë fëmijët e tyre por veçanërisht prindërit të cilët janë në procedurë të shkurorëzimit dhe pas saj.

Këto ligjerata dhe trajnime mund të mbahen në një institucion të krijuar për çështje familjare (Këshillimore familjare ) ku do të ketë psikolog të specializuar për fëmijë si dhe psikolog të specializuar në fushën e marrëdhënive bashkëshortore , pedagog dhe jurist të kualifikuar si ekspertë të fushës familjare të cilët do të veprojnë si ekip në mënyrë të koordinuar dhe do të përgatisin programe të posaçme veprimi për rastet konkrete të veçanta por edhe në përgjithësi , këto ligjerata do të ndihmonin dhe do të ndikonin edhe tek vetëdijësimi i prindërve për sjelljen dhe mënyrën e edukimit sidomos pas shkurorëzimit të martesës, por do t'i ndihmonin edhe fëmijët se si ta tejkalojnë më qetë periudhën e shkurorëzimit të prindërve të tyre.

Këto ligjerata duhet të jenë të domosdoshme dhe prindërit duhet të jenë të obliguar që të marrin pjesë , ku për prindërit të cilët janë në fazë të shkurorëzimit ligjëratat të jenë më të shpeshta dhe më intenzive duke i trajtuar më mirë çështjet që kanë të bëjnë me interesin më të lartë të fëmijës.

Kjo gjë është mjaft e rëndësishme sepse mund të arrihet që të vetëdijësohen prindërit dhe tu bëhet me dije që duhet të kenë kujdes në sjelljen e tyre dhe tua tregojnë anët pozitive që mund të arrijnë për fëmijën e tyre vetëm në qoftë se bashkëpunojnë dhe sëbashku të marrin vendime dhe veprime për interesin më të lartë të fëmijës dhe tu tregohet ana negative në qoftë se nuk bashkëpunojnë e cila sjell vetëm pasoja për fëmijën dhe asnjë dobi.

Për arsye se QPS është e stërngarkuar mendoj që duhet këto çështje të zhvendosen në këtë institucion familjar , ku do të mbahen seanca këshilluese të rregullta, trajnime, bisedime dhe mendoj se do të ketë tepër efekt dhe sukses për arsye se për momentin QPS nuk mundet që të arrijë me një seancë këshilluese që mban të arrijë që tua tërheq vërejtjen prindërve për gabimet që bëjnë gjatë kujdesit ose edukimit të fëmijëve të tyre.

Këshillimorja familjare duhet të përgatisë raporte për secilën rast veç e veç dhe të mbajë kontakte të vazhdueshme me prindërit dhe me fëmijën që mos vijë deri tek keqpërdorimi i përgjegjësisë prindore ose tek privimi i përgjegjësisë prindërore njërit prej prindërve, Kjo



këshillimore do të përgatis edhe procesverbale dhe raporte finale se si janë zgjedhur rastet konkrete.

## 7.Bibliografia

### Tekste, monografi, artikuj

- Abdulla Aliu, Haxhi Gashi. *E drejta familjare* . Prishtinë: Fakulteti Juridik- Prishtinë, 2007.
- Arta Mandro-Bilalli, Vjollca, Meçaj, Tefta Zeka, Arjana Fullani. *E drejta familjare*. Tiranë : Fakulteti i drejtësisë- Tiranë, 2006.
- Emine Zendeli,Arta Selmani Bakiu,Dejan Mickoviq,dhe Angel Ristov, E drejta familjare,Tetovë, 2020.
- Janevski Arsen E drejta procedurale civile.L.1, Edrejta Kontestimore/Arsen Janevski,Tatjana Zoroska-Kamilovska:Përktheu Emine Zendeli,Nagip Zendeli-Tetovë- Univesiteti i Evropës Juglindore,2011
- Podvorica, Hamdi, E Drejta Familjare, Prishtinë, 2005
- Podvorica, Hamdi dhe Podvorica, Fatlum, Klinika Juridike – E Drejta Familjare dhe Trashëgimore, Prishtinë, 2015
- Oruçi Gani, “E Drejta Familjare - Ligjërata të autorizuar”, Prishtinë, 1994
- Osmani Afrim,”Kodi Penal i Republikës së Maqedonisë,Teksti integral,i përpunuar në gjuhën shqipe me udhëzime dhe sqarime,treguesi alfabetik”,Shkup, Furkan ISM,2010
- Дејан Мицковиќ. *Семејството во Европа XVI-XXI век*. Скопје: Блесок, 2008.
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов. *Предлог за измени и дополнување на Закон за семејство*. Скопје, Октомври, 2014.
- Дејан Мицковиќ, Ангел Ристов. *Семејно право*. Скопје: Стоби Трејд, 2015.
- Дејан Мицковиќ и Милица ШутоваРазводот на брак во Европските земји , ДГУП “Софија” Богданци , 2020,
- Кирил Чавдар, Цветанка Сиљаноска - Костадиновска. *Коментар на закон за семејното право: коментари, судска практика, предметен регистар, примери за практична примена, придружни прописи и литература*. Скопје: Академик, 2013.

- Кирил Чавдар, Кимо Чавдар. *Коментар на закон за парнична постапка: коментари, судска практика, предметен регистар, примери за практична примена, придружни прописи и литература*. Скопје: Академик, 2016.
- Љиљана Спировиќ-Трпеновска. *Семејно право*. Скопје: Правен факултет-“Јустиниан Први”, 2008
- Доц.д-р Симеон Цветановски, М-р Билјана Тодорова, Семејно и Наследно право, Прв Приватен Универзитет Европски Универзитет Република Македонија, Скопје, 2009
- Ранко Максимовски, Граѓанско Право, статии, практика, Скопје 2011
- Наташа Најденова-Левиќ. *Проблеми во остварувањето на правото навидување на детето со родителот со кој не живее*. (Macedonian Centre for European Training) 2014.
- Љиљана Спировиќ-Трпеновска. *Семејно право*. Скопје: Правен факултет-“Јустиниан Први”, 2008
- Борче Давитковски, Гордана Бужаровска, Гордан Калаџиџев, Дејан Мицковиќ. *Implementation Handbook for the Convention on the Rights of the Child*, UNICEF, Септември 2007. Компаративен преглед на законодавството во Република Македонија и Конвенцијата за правата на детето. Министерство за правда, Скопје 2010
- Народен правобранител на Република Македонија. *Остварувањето на правото на детето да одржува лични контакти со родителот со кого не живее*. Скопје, 2012
- Cynthia C. Siebel. *Fathers and Their Children: Legal and Psychological Issues of Joint Custody*. Symposium on Fathers and Family Law. American Bar Association, 2006. стр.213-236
- Jens Martin Scherpe, Brian Sloan. *Contractualisation of Family Law in England & Wales:*

*Autonomy vs Judicial Discretion*. In *Contractualisation of Family Law Global Perspectives*, by Frederik Swennen, str. 165-191. Switzerland: Springer, 2015

- Marian Roberts. *Mediation in Family Disputes- Principles of Practice*, Third Edition. Hampshire: Ashgate Publishing Limited, 2008.
- Family Law Act 1996.
- Закон за семејството на РМ, Консолидиран текст, ноември 2015 год
- Standards of Practice for Lawyers Representing Children in Custody Cases, (Превземено од)  
[http://www.americanbar.org/content/dam/aba/migrated/domviol/pdfs/0908/Standards\\_of\\_Practice\\_for\\_Lawyers\\_Representing\\_Children.authcheckdam.pdf](http://www.americanbar.org/content/dam/aba/migrated/domviol/pdfs/0908/Standards_of_Practice_for_Lawyers_Representing_Children.authcheckdam.pdf)
- Child Custody Jurisdiction And Enforcement Act Summary, (Превземено од)  
<http://www.uniformlaws.org/actsummary.aspx?title=child%20custody%20jurisdiction%20and%20enforcement%20act>
- Uniform Child Custody Jurisdiction and Enforcement Act, (Превземено од)  
[http://www.uniformlaws.org/shared/docs/child\\_custody\\_jurisdiction/uccjea\\_final\\_97.pdf](http://www.uniformlaws.org/shared/docs/child_custody_jurisdiction/uccjea_final_97.pdf)
- Правник-списание
- Convention on the Rights of the Child 2.09.1990 (Конвенција на правата на детето), (Превземена од) <http://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/crc.aspx>
- European Convention on Recognition and Enforcement of Decisions concerning Custody of Children and on Restoration of Custody of Children, 20.05.1980 год. ,(Европската конвенција за признавањето и спроведувањето на одлуките за родителската грижа и поново воспоставување на родителската грижа), (Превземена од)  
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680078b09>

- Статистики за Склучени и разведени бракови во Република Македонија во 2015 год., Државен завод за статика на РМ, 19.05.2016, (Превземено од) <http://www.stat.gov.mk/pdf/2016/2.1.16.13.pdf>
- Gega, Klodian dhe Hasani, Naureda, “Psikologu dhe Punonjësi Social në Drejtësinë për të Miturit”, botim i Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara Klinika Ligjore për të Mitur, Tiranë, 2012
- Aktgjykimi nr:P2-31/17
- Raport për mbikqyrje të punës së ekipit profesional të QPS-Manastir-Lënda S.M.S,Shkup,Tetov,v.2018

#### **BURIME NGA INTERNETI**

- Академик, <http://www.akademik.mk/>
- Правдико, <http://www.pravdiko.mk/>
- Збирка на важечки македонски прописи на интернет, <https://www.akademika.com.mk/>
- Службен Весник на Р.Македонија, <http://www.slvesnik.com.mk/>
- Pravo, <http://www.pravo.org.mk/>
- Народен правобранител на РМ, <http://ombudsman.mk/>
- Министерство за труд и социјална политика, <http://www.mtsp.gov.mk/>
- Министерство за правда, <http://www.pravda.gov.mk/>
- Commision On European Family Law, <http://ceflonline.net/>
- Здружението емоционално здраво детство Скопје Sane childhood - Sane society” <http://sanechildhood.org/za%20nas.html>
- [www.jpacademy.gov.mk](http://www.jpacademy.gov.mk)

- Случај МИТОВИ против Република Македонија(жалба бр.53565/13) Пресуда  
Стразбур 16 април 2015
- <http://mtsp.gov.mk/content/pdf/standardi%20%20FINAL.pdf>
- Charter of fundamental rights of the EU (neni 24)
- European Convention on the Exercise of Children's Rights (1996)
- Convention on contact concerning children (2003)
- Council of Europe on joint parental responsibility in case of divorce is “White Paper” On
- Principles Concerning the Establishment and Legal Consequences of Parentage (2004)  
parimi 22
- Draft Recommendation on the rights and legal status of children and parental  
responsibilities (2010)
- Resolution (1921) on Gender equality, reconciliation of private and working life and co-  
responsibility (2013)
- Resolution (2079) on Equality and shared parental responsibility: the role of fathers  
(2015)
- <https://theitalianlawyer.com/tough-battle-of-child-custody-in-italy-all-you-need-to-know/>
- [https://www.island.is/en/family/marriage\\_and\\_partners/custody\\_of\\_children\\_and-visiting\\_rights/](https://www.island.is/en/family/marriage_and_partners/custody_of_children_and-visiting_rights/)
- <https://www.justice.gov.nt.ca/en/child-custody-and-access/>
- <https://www.nolo.com/legal-encyclopedia/types-of-child-custody-29667.html>
- [https://www.echr.coe.int/Documents/FS\\_Parental\\_ENG.pdf](https://www.echr.coe.int/Documents/FS_Parental_ENG.pdf)
- [www.rodovreactor.mk](http://www.rodovreactor.mk)
- [www.unicef.org.mk](http://www.unicef.org.mk)

- [www.zsd.gov.mk](http://www.zsd.gov.mk)
- [www.libertas.mk](http://www.libertas.mk)
- <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex:32003R2201>
- [https://ec.europa.eu/info/pS.Ocies/justice-and-fundamental-rights/rights-child\\_en](https://ec.europa.eu/info/pS.Ocies/justice-and-fundamental-rights/rights-child_en)
- [www.majkaidete.mk](http://www.majkaidete.mk)
- [www.family.findlaw.com](http://www.family.findlaw.com)
- [www.parents.com](http://www.parents.com)
- [www.divorcenet.com](http://www.divorcenet.com)
- [www.wikipedia.org](http://www.wikipedia.org)
- [www.childsupportlaws.co.uk](http://www.childsupportlaws.co.uk)
- [www.lawyersspain.eu](http://www.lawyersspain.eu)
- [www.legalmatch.com](http://www.legalmatch.com)
- [www.family.findlaw.com](http://www.family.findlaw.com)
- [www.divorceattorneynyc.com](http://www.divorceattorneynyc.com)
- [www.custodyxchange.com](http://www.custodyxchange.com)
- [www.children-and-divorce.com](http://www.children-and-divorce.com)
- [www.gazetadita.al](http://www.gazetadita.al)
- [www.liveabout.com](http://www.liveabout.com)